



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

*Qeveria - Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*

# 100 DITË

## QEVERISJE E MIRË

PRISHTINË, MAJ 2020



# **100 DITË**

## **QEVERISJE E MIRË**

PRISHTINË, MAJ 2020

Faqja është lënë qëllimisht zbrazët



## Hyrje

Ky raport paraqet punën gjatë periudhës 4 shkurt – 6 maj 2020, nga ana e Qeverisë, e cila është votuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës më 3 shkurt 2020.

Raporti fillon me fjalën e Kryeministrit të Kosovës, z. Albin Kurti, me rastin e mbledhjes së 31 të Qeverisë. Më tutje, paraqiten të arriturat kryesore sipas sektorëve të paraparë me Programin e Qeverisë.<sup>1</sup>

---

<sup>1</sup> Raporti është përmbledhës dhe si i tillë nuk përfshin të gjitha të arriturat gjatë kësaj periudhe kohore.

PËRMBAJTJA	
<b>FJALA E KRYEMINISTRIT</b>	08
<b>01. QEVERISJA</b>	10
Menaxhimi i financave publike	12
Menaxhimi i ndërmarrjeve publike	16
Qeverisja lokale	16
<b>02. SUNDIMI I LIGJIT</b>	18
Të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe komunitetet	19
Dënimi i krimeve të luftës	21
Rishikimi funksional i drejtësisë	21
Konsolidimi i drejtësisë civile dhe rregullimi i çështjeve pronësore	22
Konsolidimi i drejtësisë penale	22
Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit	22
<b>03. ZHVILLIMI EKONOMIK</b>	24
Politikat tregtare	25
Tregu i punës dhe punësimi	27
Bujqësia dhe zhvillimi rural	27
Teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK)	29
Zhvillimi i balancuar rajonal	29
<b>04. ARSIMI DHE SHKENCA</b>	30
Rritja e cilësisë së mësimdhënies në arsimin fillor dhe të mesëm	31
Arsimi dhe aftësimi profesional	33
Arsimi i lartë	33
<b>05. SHËNDETËSIA</b>	34
Riorganizimi i sektorit shëndetësor	36
Përmirësimi i shërbimeve dhe shërbimet shëndetësore	38
<b>06. POLITIKAT SOCIALE</b>	40
<b>07. MJEDISI DHE INFRASTRUKTURA</b>	42
<b>08. ENERGJIA DHE MINIERA</b>	46
<b>09. KULTURA DHE SPORTI</b>	48

Arti dhe kultura	49
Libri dhe veprimtaria botuese	49
Përmirësimi i infrastrukturës kulturore	50
Mbështetja financiare për kulturën	50
Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore	50
Sporti	51
Modernizimi i infrastrukturës sportive	51
Rinia	51
<b>10. MBROJTJA DHE SIGURIA</b>	<b>52</b>
Forcat e armatosura	53
Policia	54
<b>11. POLITIKA E JASHTME, INTEGRIMI DHE MËRGATA</b>	<b>56</b>
Politika e jashtme dhe diplomacia	57
Integrimi euro-atlantik	57
Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal	58
Mërgata	60



## Fjala e Kryeministrit



Të dashur qytetarë.

Me 6 tetor me votën tuaj vendosët që opozita e djeshme të bëhej qeveria e sotme. Vendosët për ndryshim të qeverisjes së vendit, zgjidhët Lëvizjen VETËVENDOSJE! të parën, kurse mua që isha kandidat për kryeministër më bëtë për të dytën herë më të votuarin në vend. Me 3 shkurt deputetët jetësuan këtë qeveri dhe sot janë bërë 100 ditë të punës sonë të përbashkët.

Unë u zgjodha kryeministër në kohën kur ju në secilin sondazh në 10 vitet e fundit keni thënë se korrupsioni, krimi i organizuar dhe papunësia janë problemet tona kryesore, prandaj ju vetë i vendosët prioritetet e qeverisë sonë – luftën kundër korrupsionit dhe zhvillimin ekonomik, pra drejtësi dhe punësim.

Në këto 100 ditë morëm afër 200 vendime me të cilat zvogëluam kabinetin qeveritar, përgjysmuam pagat për qeverinë, ulëm shpenzimet dhe privilegjet dhe parandaluam keqpërdorimin me paranë publike.

- 1.4 milion euro në vit do të kursehen pasi ka më pak ministra, zv. ministra, këshilltarë e asistentë.
- 1.1 milion euro në vit do të kursehen nga përgjysmimi i pagave të qeveritarëve.
- Mbi 300 mijë euro në vit dhe do të kursehen nga heqja e privilegjeve të shumta dhe shpenzimeve në telefona, makina e udhëtime zyrtare, dreka e darka.

Ju votuat për një kabinet të vogël sepse jemi vend i vogël dhe për paga më të ulëta sepse jemi vend i varfër!

Zgjidhëm një kabinet me ministra të ri e të pakorruptuar dhe ndërruam bordet e ndërmarrjeve publike që punonin me humbje, punësonin familjarë pa kritere e pa meritë dhe po instalojmë profesionalizmin, llogaridhënien dhe do të ndalim abuzimin me paranë publike.

Parandaluam keqpërdorimin e qindra miliona eurove me kontrata të dëmshme të lobimit që me paratë e qytetarëve pastronin imazhin e liderëve të korruptuar dhe anuluan tenderë për asfalt e shpronësim të tokave bujqësore që synonin zhvatjen e parasë publike.

- 50 milionë euro të për zgjatjen e autostradës Arben Xhaferri, u anuluan.
- 110 milionë euro për auto udhën për Gjilan, u anuluan.
- 7 milionë euro për projektin e motivuar politikisht për zonës ekonomike në Malishevë, u anuluan.
- 1 milion euro kontrata në lobime e qira, u anuluan.
- U anuluan kontrata afatshkurtra të jashtëligjshme për shërbime të veçanta dhe pozita fiktive.
- Mbi 550 mijë euro në vit do të kursehen nga kursimet në Postë dhe Telekom që shkonin në paga e privilegje.
- U kthyen konsuj dhe ambasadorë të emëruar paligjshëm duke i hapur rrugë meritokracisë dhe përvojës.
- Mbi 70 milionë euro shtesë janë siguruar për Ministrinë e Shëndetësisë për të rregulluar infrastrukturën e munguar në spitalet tona publike. Në këtë krizë të pandemisë me COVID-19, ne po bëjmë investimet e munguara.
- Afër 200 milionë euro u ndanë për pakon emergjente fiskale për të përballuar krizën ekonomike dhe për të ndihmuar rastet sociale të prekur më së shumti nga kriza.
- Ndhimua policët, inspektorët, punëtorët shëndetësor dhe grupet e ndjeshme me paga shtesë gjatë pandemisë.

E në këto 100 ditë patëm 100 pengesa dhe menaxhuam 3 kriza. Një krizë e pashmangshme shëndetësore të pa-përjetuar në jetën e secilit nga ne, një krizë e paevitueshme ekonomike që erdhi si pasojë e krizës shëndetësore dhe një krizë e panevojshme politike. Ne menaxhuam me sukses pandeminë COVID-19. Masat e hershme të qeverisë, puna heroike e punonjësve shëndetësor dhe policorë si dhe bashkëpunimi i duhur qytetar e kanë bërë Kosovën tregim sukcesi, por virusi është ende mes nesh dhe rreziku nuk ka kaluar. Do të vazhdojmë të jemi të kujdesshëm maksimalisht. U punua në arsim, në kulturë, në rini e në sport, por këto ishin vetëm 100 ditë.

Të dashur qytetarë, ju votuat për ndryshim dhe qeverisje të mirë. Këto 100 ditë ishin ditë të qeverisjes së mirë, pa krim e korrupsion.

Bashkë bëjmë gjithçka të mundur, bashkë do të qeverisim mirë çdo ditë.  
Vazhdojmë...

**Albin KURTI**



Kryeministër në detyrë i Republikës së Kosovës



01

# Qeverisja

Programi 2020-2023, i miratuar nga ana Qeverisë ka përcaktuar orientimet kryesore për zbatimin e zotimeve që janë marrë karshi qytetarëve, dhe që fokusohet në përmirësimin e gjendjes në ato fusha, ku nuk ka progres të ndjeshëm, si në:

i) drejtësi; ii) ekonomi dhe punësim; iii) arsim; iv) shëndetësi; v) siguri vi) integritet euro-atlantike dhe vii) mjedis.

Ky 100 ditësh i është kushtuar Qeverisjes së Mirë, prandaj edhe në kuadër të 30 mbledhjeve të organizuara ku janë marrë 125 vendime, kryesisht janë fokusuar në adresimin e problemeve strukturore në qeverisje, borde dhe ndërmarrje të ndryshme dhe gjithashtu në menaxhimin e situatës së krijuar nga pandemia COVID-19.

Kemi filluar më një Kabinet qeveritar shumë më të vogël se Qeveritë pararendëse, që për qëllim ka Qeverisje më të mirë, kursimet dhe uljen e shpenzimeve, për t'i orientuar ato në funksion të zhvillimit ekonomik.

Rezultatet kryesore në kuadër të planifikimit, zhvillimit dhe koordinimit të politikave përfshijnë:

- **Miratimi i Koncept Dokumentit për zvogëlimin e Barrës Administrative** – përmes të cilit parashikohet zvogëlimi i ngarkesave administrative për kompanitë, qytetarët dhe administratën për 30% brenda kornizës aktuale të legjislacionit parësor, brenda një periudhe kohore prej 8 vjetësh.
- Në kuadër këtij procesi gjatë kësaj periudhe janë analizuar 20 ligje për të ardhur te një metodologji e cila do të identifikojë ngarkesat administrative aktuale për bizneset, qytetarët dhe administratën.
- Në kuadër të Dialogut Ekonomik dhe Financiar ndërmjet Kosovës dhe BE-së janë miratuar Konkluzionet e Përbashkëta.
- Është përgatitur dokumenti punues për përmirësimin e **Kornizës kombëtare për menaxhim strategjik**, i cili përfshinë opsionet për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim. Si pjesë e fazës analitike për **Strategjinë Kombëtare për Zhvillim**, ka filluar Rishikimi Shumë-dimensional i vendit.
- Është rishikuar vendimi për Ekipën Nacionale për

100  
ditë  
30  
mbledhje  
125  
vendime

**Specializim të Mençur**, dhe kanë filluar procedurat për analizën e potencialit ekonomik, shkencor dhe inovativ ;

- Në kuadër të procesit legjislativ gjatë kësaj periudhe, Qeveria ka miratuar pesë (5) projektligje për ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare, si dhe tre akte nënligjore;
- Duhet të theksohet Rregullorja për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, që ka përcaktuar ristrukturimin e kabinetit të ri qeveritar.

Në kuadër të plotësimit të standardeve për transparencë dhe qeverisje të mirë, është finalizuar dhe publikuar raporti për konsultime me publikun për vitin 2019.

Është finalizuar Koncept Dokumenti për hartimin e Ligjit për Regjistrimin e popullsisë dhe banesave 2021; Përgatitja e draft udhëzimit administrativ mbi konfidencialitetin e të dhënave statistikore; Përgatitja e draft udhëzimit administrativ mbi shitjen e të dhënave statistikore; Regjistrimi i Popullsisë: Përgatitjet për Regjistrimin e popullsisë 2021 janë realizuar sipas planit.

Është finalizuar Anketa e Tregueseve të Shumëfishtë (bashkëpunim i ASK dhe UNICEF-it) e njohur si MICS6 ka përfunduar grumbullimi i të dhënave nga terreni, mars 2020, nga kjo ankete do të nxjerrën rreth 40% të treguesve social për Objektivat për zhvillim të qëndrueshëm - SDG.



foto 1

Kabineti Qeveritar i Kryeministrit z. Albin Kurti: z. Avdullah Hoti\*, z. Haki Abazi, z. Agim Veliu\*\*, znj. Albulena Haxhiu, z. Anton Quni, z. Arben Vitia, z. Besian Mustafa, z. Besnik Bislimi, z. Blerim Reka, z. Dalibor Jevtić, znj. Emilija Redžepi, z. Glauk Konjufca, znj. Hykmete Bajrami, z. Ivan Millojević, z. Lumir Abdixhiku, znj. Rozeta Hajdari, znj. Vlora Dumoshi

## Menaxhimi i financave publike

Qeveria e Kosovës ka përgatitur dhe miratuar buxhetin për ndarjet buxhetore për vitin 2020, duke përmirësuar keq klasifikimet e shpenzimeve ndërmjet shpenzimeve kapitale dhe mallra e shërbime; reduktimi i numrit fiktiv të punëtorëve për 684 pozita; korrigjimi i pjesës tekstuale të ligjit; adresimi i obligimeve të papaguara nga organizatat buxhetore.

Duke u bazuar në vendimin e Qeverisë së Kosovës ka filluar zbatimi nga Dogana i vendimit të Qeverisë për largimin e taksës 100% dhe zëvendësimi me reciprocitetin. Importet nga Serbia nga fillimi i zbatimit të këtyre masave kanë qenë 12.4 milionë euro, ndërsa janë eksportuar në Serbi mallra në vlerë 0.7 milion euro.

\*i shkarkuar më datë 25.03.2020

\*\*i shkarkuar më datë 18.03.2020

largimi i taksës  
**100 %**  
zëvendësimi me  
**reciprocitet**



Janë udhëzuar ministritë, subjekt i ristrukturimit, për mënyrën e funksionimit deri në hyrjen në fuqi të ligjit për buxhetin dhe pas tij, deri në organizimin e ri me rregullore të brendshme.

### **Vendime të rëndësishme që janë ndërmarrë gjatë kësaj periudhe përfshijnë:**

- Është aprovuar në parim nisma e Ministrisë së Financave dhe Transfereve për negocimin e Marrëveshjes për Eliminimin e Tatimit të Dyfishtë dhe Parandalimin e Evazionit Fiskal lidhur me Tatimin në të Hyra dhe Kapital në mes të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Republikës së Finlandës, si dhe ajo me Mbretërinë e Holandës.
- Është aprovuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për Projektin e fuqizimit të sektorit financiar.
- Është aprovuar kërkesa e Ministrisë së Financave për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 200 mijë euro si mbështetje financiare për Republikën e Shqipërisë për qëllim të ndihmës në sanimin e dëmeve nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019.
- Është aprovuar mbështetja financiare për evitimin e dëmeve nga fatkeqësia natyrore në Komunën e Pejës dhe Istogut në shumën prej 433,050 Euro.
- Është aprovuar ndarja e mjeteve në shumën prej 29,809.10 Euro për projektin e GlZ të cilët i kanë mbështetur refugjatët gjatë qëndrimit në parkun inovativë të Biznesit në Prizren, me rastin e tërmetit në Shqipëri.
- Është shfuqizuar vendimi i Qeverisë nr. 20/64 i datës 11.09.2018 për aprovimin e Koncept dokumentit për ndryshimin e politikave fiskale dhe bujqësore për prodhimin e duhanit dhe cigareve në Kosovë.
- Me qëllim të racionalizimit të shpenzimeve të parasë publike për përdorimin e telefonave është shfuqizuar vendimi i deritanishëm dhe ka filluar hartimi i udhëzimit administrativ për këtë qëllim.

### **Në kuadër të menaxhimit të situatës së krijuar nga COVID-19, janë arritur këto rezultate:**

- Janë ndarë mjete financiare në shumë prej 400 mijë Euro për Ministrinë e Shëndetësisë për parandalimin e situatave të mundshme emergjente për epidemi, dhe pastaj edhe 10 milionë euro tjera pas shfaqjes së pandemisë edhe në Kosovë.
- Janë ndarë 500 mijë Euro për Komunat e Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit me qëllim të përballimit të gjendjes së krijuar nga pandemia. Ky transfer i mjeteve nga Qeveria e Republikës së Kosovës në llogaritë e tri Komunave të Luginës, në Bankën Qendrore të Serbisë është bërë për herë të parë dhe paraqet një moment të ri për Kosovën.
- Është aprovuar vendimi për lirimin e përkohshëm nga pagesa e TVSH-së të të gjitha importeve të grurit dhe miellit të prodhimin e bukës dhe produkteve të bukës.
- Me qëllim të lehtësimit të pengesave të amvisërive dhe bizneseve gjatë periudhës së pandemisë janë aprovuar vendimet për shtyrjen e afateve të raportimit, deklarimit dhe pagesës së tatimeve si dhe për pezullimin e aplikimit të kamatës dhe gjobës për mos pagesën e tatimit në pronë, deri më 31 dhjetor 2020.
- Është hapur llogaria e dedikuar e Thesarit për fondet për menaxhimin e situatës së pandemisë, në të cilën, deri më datë 8 maj 2020 vetëm nga donacionet janë mbledhur mbi 700 mijë euro.
- Është siguruar financimi prej 102 milion euro, 52 milion euro nga kredia me FMN si dhe 50 milion euro letra me vlera (obligacion 10 vjeçar).

**Kursimet në shpenzime brenda ministrisë së Financave dhe Transfereve** - Kursimet e kësaj qeverie për periudhën 03.02.2020 deri në 23.04.2020 arrijnë në 146,961<sup>1</sup> euro në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Më saktësisht, deri në 23.04.2020 kabinetet e ministrave në të gjithë qeverinë kanë shpenzuar 85,710, ndërsa shpenzime e qeverisjes së mëparshme, për të njëjtën periudhë të qeverisjes, arritën vlerën 232.641 euro.

**Anulimi i vendimeve për shfrytëzimin e veturave zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë** - Edhe pse sipas Udhëzimit Administrativ të vitit 2009, të drejtën për shfrytëzim të veturave 24 orë e kanë pasur ligjërisht vetëm nivelet e larta, faktikisht veturat 24 orë janë shfrytëzuar edhe nga drejtorët e departamenteve dhe persona tjerë. Me vendimin e Ministrisë janë ndaluar këto keqpërdorime në shfrytëzimin e veturave zyrtare, duke arritur kurseme në shpenzimin e derivateve e njëkohësisht vendosje të ligjshmërisë.

**Kursimet në kuadër të Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit** - Janë reduktuar ndjeshëm shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe janë mënjanuar nga buxheti projekte disa milionëshe të cilat kanë qenë të përfshira në kundërshtim me legjislacionin dhe procedurat në fuqi.

**Kursimet në kuadër të Ministrisë së Integritimit Evropian** - Në Ministrinë për Integritim Evropian janë gjetur dhe trashëguar obligime financiare lidhur me dy kontrata lobuese, një kontratë për shërbime të informimit, si dhe një kontratë për qiranë e objektit për zyrat e Ministrisë siç janë:

- Kontrata lobuese që janë lidhur për suvatimin e figurave publike pa sjellë asnjë dobi për qytetarët, të trashëguar nga qeverisja e kaluar dhe kapin vlerën e 1,200,000 euro.
- Kontrata për shërbime të informimit me vlerë totale 881,389 euro për 3 vite.
- Kontrata mbi Qiranë për vendosjen e tërësishme të zyrave të MIE-së në objekt privat me vlerë 23,014 euro në muaj.

<sup>1</sup> Duke marrë parasysh që disa fatura të kabinetit të mëparshëm (shpenzimet e krijuara para 03.02.2020) janë raportuar si shpenzime të rrjedhura në muajt e ardhshëm (raportuar si shpenzime të derivuara në periudhën 03.02.2020-24.04.2020). Kështu që, vlera reale e kursemeve të vërteta të krijuara nga kjo qeveri është edhe më e lartë se numri i paraqitur më sipër.

Pas shkëputjes së Kontratës mbi Qiranë për Ministrinë e Integritimit Evropian si dhe bartjen e stafit në objektin e Qeverisë, nga 20 mars 2020, kursehen 23,014 euro në muaj apo rreth 320,000 euro në vit, së bashku me shpenzimet mujore, të cilat janë rreth 40,000 euro në vit. Vlera e përgjithshme e kursemeve nga anulimi i kësaj kontrate shkon në gjysmë milioni pasi kontrata ishte parashikuar për 2 vjet.

Po ashtu, vlen të theksohet se mjetet financiare të destinuar për pagesën e qirasë së objektit në vlerë prej 280,000.00 euro për këtë vit, janë ri destinuar/ri-organizuar në mënyrë që me këtë shumë të mjeteve të mbulohen obligimet e mbetura/vijuese ndaj kontratave të lobimit, (varësisht nga epilogu gjyqësor) si dhe pjesa tjetër parashihet që të destinohen për shërbime të mirëfillta të konsulencës përkatëse që kontribuojnë në procesin e integritimit Evropian të Kosovës.

Nga muaji mars 2020, janë reduktuar shpenzimet nga buxheti i MIE-së për shërbimet e transportit me ndërprerjen e kontratave "rent a car" për 4 vetura zyrtare duke kursyer 1,041 euro në muaj, apo 12,492 euro në vit, me rastin e reduktimit të tre veturave për përdorim nga zyrtarët publik.

Në frymën e kursemeve, në total është arritur të kursehen rreth 15% të shpenzimeve të parapara në buxhetin e MIE-së për tremujorin e parë, 2020.

Është urdhëruar ndërprerja dhe mos-vazhdimi i kontratave/marrëveshjeve për shërbime të veçanta, të ndalen të gjitha emërimet, punësimet, kontratat pas 19 korrikut 2019, sepse do konsiderohen të paligjshme dhe do të pasojë përgjegjësia gjyqësore për shpërfillësit e pozitës zyrtare.

**Kursimet në kuadër të MEPTINIS** - MEPTINIS ka propozuar edhe vendimin e Qeverisë që anulon vendimet e kundërligjshme për zonën ekonomike dhe shpronësimet e ndërlidhura në komunën e Malishevës. Me këtë anulim, Qeveria ka ndaluar përpjekjet për të krijuar një zonë ekonomike në kundërshtim me ligjin dhe planin kombëtar, pa studim fizibiliteti dhe pa dëgjim publik. Gjithashtu, ka shpëtuar miliona euro që do të paguheshin për shpronësimin e panevojshëm të pronave private, që më parë ishin privatizuar me çmim dukshëm më të ulët. Kostoja e përgjithshme e këtij projekti është 7 milionë euro.

Në Telekomin e Kosovës, ka pasur reduktim të shpenzimeve të panevojshme, një prej të cilave është edhe ulja prej 65% e pagës së UD e KE. Kursimi i përgjithshëm vjetor: 550,000 euro.

Fig 1. Krahasimi i shpenzimeve të kabinetit të ministrave e kësaj qeverie për periudhën 03.02.2020 deri në 23.04.2020 me të njëjtën periudhë të vitit 2019

## SHPENZIMET




Fig 2. Pakoja Emergjente Fiskale - Është dizajnuar dhe ka filluar të zbatohet Pakoja Fiskale Emergjente, në vlerë totale të 189,650 milionë euro, si mbështetje për të tejkaluar situatën e emergjencës shëndetësore.

Kategoria	Si % e totalit të Pakos	Në vlerë totale në euro
Spektori Publik	26%	50,000,000
Spektori Privat	60%	114,000,000
Mirëqenie Sociale	14%	25,650,000
	<b>100%</b>	<b>189,650,000</b>

# 189,650,000 €

## Pakoja emergjente

Në kuadër të saj deri më 8 maj 2020, janë paguar:

- a. 5,181,034 euro shtesë për dy muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale (100 mijë përfitues nga kjo skemë);
- b. 4,880,610 euro shtesë për skemat pensionale dhe sociale me pagesë mujore deri në 100 euro (nga kjo kanë përfituar 162,687 persona);
- c. 13,703,360 euro për subvencionim të pagës në vlerë 170 euro për 80,608 punonjës të sektorit privat të prekur nga vendimet e Qeverisë për parandalimin e rrezikut të infektimit;
- d. 6,752,119 euro shtesë mbi pagë për 21,518 punonjës të sektorit publik të cilët me vendime të Qeverisë janë ekspozuar me rrezik të shtuar ndaj infektimit gjatë kryerjes së punës së tyre.

Në kuadër të Pakos Emergjente Fiskale edhe janë regjistruar 11,633 punëtorë të ri, përderisa janë deklaruar si të larguar nga puna vetëm 1,459 punëtorë. Për të gjithë këta është siguruar mbështetja financiare prej 130 euro për muaj.

### Menaxhimi i ndërmarrjeve publike

Në kuadër të rolit mbikëqyrës së ndërmarrjeve publike qendrore janë shqyrtuar dhe përmbushur kërkesat për përkrahje financiare dhe administrative, dhe si rrjedhojë janë nënshkruar 7 marrëveshje për mbikëqyrjen e subvencioneve me ndërmarrjet publike.

Janë përmbyllur marrëveshjet për dy marrëveshje të volitshme financimi të sektorit të ujërave:

- Një marrëveshje me Bankën Botërore i siguron KRU Hidromoravës së Gjilanit kredi 25.1 milionë euro për ndërtimin e një dige dhe për infrastrukturën e ujësjellësit dhe të kanalizimit.

- Një marrëveshje tjetër me thesarin e Republikës Franceze i siguron KRU Prishtinës kredi 66 milionë euro për impiantin e ujërave të zeza.

Në kuadër të përmirësimit të gjendjes në ndërmarrjet publike, janë marr vendime kyç për të adresuar shkeljet dhe për të shpëtuar ndërmarrja nga keqqeverisja, keqpërdorimet dhe humbjet e thelluara.

Qeveria ka marrë 12 vendime lidhur me shkarkimin dhe emërimin e bordit të drejtorëve në 8 ndërmarrje. Tutje, janë nxjerrë 7 vendime për të emëruar komisionet e auditimit në ndërmarrje publike.

Janë shkarkuar dhe emëruar bordet në këto ndërmarrje publike:

1. Telekom i Kosovës Sh. A.
2. Ndërmarrja "Trepça" Sh. A.
3. ShSKUK
4. Ndërmarrja KRU "Prishtina" Sh. A.
5. Posta e Kosovës Sh. A.
6. "Hekurudhat e Kosovës Infrakos" Sh. A.
7. "Korporata Elektroenergjetike e Kosovës" Sh. A.
8. Ndërmarrja "Ibër Lepenc" Sh. A.
9. Ndërmarrja KRU "Prizren" Sh. A.

### Qeverisja lokale

Aktivitetet kryesore në kuadër të administrimit të pushtetit lokal përfshijnë:

- Ka vazhduar plotësimi i kuadrit ligjor në zhvillimin e drafteve të akteve të reja nënligjore si dhe plotësim ndryshimi i akteve ekzistuese.
- Janë zhvilluar aktivitete për plotësim-ndryshimin e udhëzimit administrativ për transparencë, për shkak të ndryshimit të ligjit për qasjen në dokumentet publike.
- Janë përgatitur vendimet për shfuqizimin e Udhëzimit të Brendshëm (MAPL) Nr. 01/2015 për inventarizimin e

pasurisë jo financiare dhe Udhëzimit të Brendshëm (MAPL) Nr. 02/2015 për vlerësimin dhe tjetërsimin e pasurisë jo financiare.

- Është themeluar grupi punues për vlerësimin Ex-post të Ligjit për Zgjedhjet Lokale në Kosovë, i cili ka hartuar i raportin për vlerësimin Ex-post të Ligjit.

Janë bërë të gjitha përgatitjet për:

- Draftimin e Projekt rregullore për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të komunës;

- Projekt Udhëzimi Administrativ (MAPL) për procedurën e Emërimit të Nënkyetarëve në Komuna;

- Projekt Udhëzim Administrativ për Sekretaritë e Kuvendeve të Komunave;

- Projekt Udhëzimin Administrativ (MAPL) për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe Kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë.

Marrë parasysh spektrin e gjerë të kompetencave komunale, është zbatuar një mekanizëm i kontrollit përmes monitorimit elektronik dhe monitorimit të drejtpërdrejtë në organet e administratës lokale. Gjatë periudhës 100 ditore kuvendet kanë mbajtur 93 mbledhje, prej tyre janë monitoruar përmes tele-prezencës 88 mbledhje kurse 5 mbledhje të tjera janë monitoruar me prezencë fizike të zyrtarëve për monitorim në komunat: Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Novobërdë, Zubin Potoku dhe Zveçan. Kuvendet e komunave kanë aprovuar 330 akte, prej të cilave MAPL ka bërë vlerësimin e ligjshmërisë së 208 akteve dhe 122 akte janë proceduar për vlerësim të ligjshmërisë në ministritë e linjës. Janë konstatuar 17 akte të kundërligjshme të kuvendeve të komunave, për të cilat janë dërguar 17 kërkesa për rishqyrtim. Si rrjedhojë 4 akte janë harmonizuar nga kuvendet e komunave ndërsa 9 janë brenda afatit kohor për rishqyrtim. MAPL ka ndërmarrë veprimet procedurale për kundërshtim të 4 akteve në gjykatën themelore, përmes Ministrisë së Drejtësisë.

**Zhvillimi i qëndrueshëm komunal** - Në kuadër të programit komunal për zhvillim të infrastrukturës socio-ekonomike dhe bashkëpunim ndër-komunal për financimin e projekteve në komuna, janë përgatitur kriteret për financim dhe është

lansuar thirrja për aplikim. Nga kjo thirrje janë financuar 11 projekte në 8 komuna në vlerë prej 630,000 euro.

Gjithashtu, janë përgatitur kriteret për financim për komunat me shumicë serbe dhe është lansuar thirrja për aplikim për këto komuna me shumicë serbe, dhe tani janë në fazën e vlerësimit të aplikimeve nga komunat.

Është nënshkruar marrëveshjet ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Botërore për Projektin me Bankën Botërore "Përfshirja e të Rinjve në Zhvillimin Ekonomik Lokal".

Po ashtu, gjatë periudhës 100 ditore janë ndërmarrë të gjitha veprimet për të negociuar projektin e dytë të Bankës Botërore, lidhur me përfshirjen e të rinjve dhe ndërmarrësisë. Projekti do të implementohet në 38 Komuna.

**Performanca, transparenca dhe ngritja e kapaciteteve në Komuna** - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me partnerët e saj SDC-DEMOS, SIDA dhe Ambasadën Norvegjeze në Kosovë, kanë përmbyllur procesin e përzgjedhjes së komunave përfituese nga granti i paraparë i performancës komunale për vitin 2020.

**COVID-19** - Veprimet e ndërmarra në raport me këtë pandemi, kanë qenë të orientuara kryesisht në koordinimin e aktiviteteve ndërmjet nivelit qendror dhe komunave. Përkatesisht, janë adresuar tek komunat një sërë kërkesash dhe njoftimesh tek kryetarët e komunave, kryesuesit e kuvendeve të komunave, Qendra Operative Emergjente (QOE), Qendra Operative e MPBAP(QOMPAP) dhe Qendrën për Parandalim dhe Kontroll të Sëmundjeve (QPKS) me këto prioritete.

# 02 Sundimi i ligjit



foto 2

Kryeministri Kurti bashkë me u.d. Ministrin e MPBAP dhe drejtorin e Policisë në pikën e kontrollit të hyrje-daljeve në kryeqytet.

### **Të drejtat e njeriut, barazia gjinore dhe komunitetet**

Me qëllim të avansimit të drejtave të njeriut në përgjithësi dhe të drejtave të grupeve të cenueshme në veçanti, Qeveria e Republikës së Kosovës ka ndërmarrë disa aktivitete.

Në bashkëpunim me shoqatën e personave të shurdhër në Kosovë, ka ofruar shërbime në gjuhën e shenjave për qytetarët që nuk dëgjojnë, janë angazhuar 16 interpretë të gjuhës së shenjave dhe kanë përfituar Shërbime në gjuhën e shenjave **121 qytetarë** në të gjithë Republikën e Kosovës.

Qeveria e Kosovës i ka dhënë theks të veçantë qasjes dhe informimit për personat me aftësi të kufizuar, **janë shtypur 13 ligje dhe akte nën ligjore në alfabetin Braille**, në mënyrë që qytetarët e verbër të kenë qasje dhe njohuri në legjislacionin. Kanë përfituar 14 shoqata komunale për

personat e verbër, 2 biblioteka dhe 1 qendër burimore në Komunën e Pejës. Tirazhi i shtypur në Alfabetin Braille është gjithsej 91,940 faqe.

## **16 interpretërë** në gjuhën e shenjave

## **13 ligje** në alfabetin Braille



Me qëllim të **mbrojtjes nga diskriminimi dhe trajtimit të barabartë** pa dallim orientimi seksual, është mbajtur takimin e Grupit Këshillëdhënës dhe Koordinues për të Drejtat e Komunitetit LGBTI (Lesbikë, Gej, Biseksual dhe Transgjindor, Interseks) më 10 mars 2020. Në bashkëpunim me projektin për Integrimin Romë 2020 të Këshillit të Bashkëpunimit Rajonal, ka bërë analizën kombëtare mbi politikat e kyçe, që synojnë integrimin e romëve në Kosovë.

Me 05-06 mars 2020, janë organizuar takime sektoriale për **zbatimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit për përfshirjen e komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë Kosovare 2017-2021**. Në fushën Arsimit janë ndarë **593 bursa për 2019-2020 vitin shkollor për Komunitete rom ashkali** dhe egjiptian në nivelin e arsimit të shkollës së mesëm të lartë dhe arsimit të lartë.

Është hartuar plani i aktiviteteve për zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijës dhe është finalizuar raporti i parë për monitorimin e zbatimit të aktiviteteve të parapara me Planin e Veprimit të kësaj Strategjie.

Për të adresuar të drejtat e gruas, është prezantuar drafti final i **Programit të Kosovës për Barazi Gjinore dhe planin e veprimit 2020-2024**, pikërisht më 8 mars – në Ditën Ndërkombëtare të Gruas. Programi përfshin qëllimet e zhvillimit të qëndrueshëm që kanë të bëjnë me gjininë dhe janë integruar 40 indikatorët gjinorë të Sfidave të Mijëvjeçarit të njohura edhe si *Sustainable Development Goals* – SDG në objektivat dhe aktivitetet e programit të propozuar.

Qeveria e Kosovës ka vazhduar bashkëpunimin me Fakultetin Ekonomik për **rishikimin e kurrikulës së fakultetit dhe vendosjen e lëndës së re “Ekonomiksi Gjinor” (Gjinia dhe ekonomia)**, ku është finalizuar lënda e re, sylabusi i ri, për përfshirjen e perspektivës gjinore në proceset e mësimdhënies dhe mësimnxënies në fushën e ekonomisë. Për nevojat e studentëve të Fakultetit Ekonomik të cilët do të ndjekin lëndën e re ABGJ ka siguruar një fond librash 5 tituj akademik në gjuhën angleze, 34 kopje, të cilat i janë dorëzuar FE/UP me 11 mars.

Për të adresuar pozitën e pafavorshme ekonomike të grave të Kosovës dhe mungesën e qasjes në pronë, që si rrjedhojë

pengon avancimin e pozitës së tyre ekonomike dhe ushtrimin e të drejtës së njeriut për qasje, zotërim dhe gëzim të pronës private, **Qeveria ka vazhduar masën afirmative edhe për një vit 2020-2021, e miratuar me 17 prill 2020.**

## Është finalizuar dokumenti “Ndihma zyrtare Ndërkombëtare për Zhvillim në Fushën e Barazisë Gjinore në Kosovë 2015-2018”.

**Adresimi i çështjeve që kanë të bëjnë me dhunën në familje**  
Me qëllim të fuqizimit të institucioneve që punojnë në këtë drejtim, Qeveria ka ndarë buxhetin për të gjitha strehimoret që ofrojnë shërbime strehimi për mbrojtje nga dhuna në familje (11 strehimore në nivel vendi). Është funksionalizuar plotësisht databaza e integruar e të dhënave për evidentimin e rasteve të dhunës në familje si dhe është formuar Komisioni për Kompensimin e Viktimave të Krimit. Gjithashtu, janë përfunduar procedurat për kalimin e strehimores së Sigurisë së Lartë nën menaxhim të Ministrisë.

Gjatë pandemisë, janë marrë veprime për plotësimin e nevojave specifike të viktimave të dhunës në familje. Kështu, është identifikuar dhe ndarë një pjesë e Qendrës së Studentëve në shërbim të viktimave të dhunës në familje (karantinimi) si dhe furnizimi me nevoja elementare. Për më shumë, në bashkëpunim me agjencitë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, UNFPA dhe UNWOMEN, të gjitha strehimoret janë furnizuar me pako ushqimore dhe higjienike. Po ashtu, për fëmijët që janë në strehimore, janë siguruar pajisje teknologjike për vijimin e mësimin online. Deri më tani kjo strehimore në karantinë e menaxhuar nga MSH ka strehuar 11 raste viktime të dhunës në familje (5 fëmijë dhe 6 gra). Pas testimit, 6 raste janë larguar nga strehimorja e karantinës dhe shërbimet janë duke i marrë në familjet e tyre.

**Për të adresuar nevojat e komuniteteve në veçanti gjatë kësaj kohe** për tejkalimin e pandemisë së COVID-19 janë koordinuar të gjithë mekanizmat institucionale. Në këtë drejtim, në bashkëpunim edhe me Doganën dhe Policinë e



Kosovës, është mundësuar shkuarja dhe kthimi nga Serbia i pacientëve në gjendje të rëndë, të cilët kanë sigurim shëndetësor në Serbi. Ky veprim paraqet hap konkret në ndërtimin e besimit ndërmjet komunitetit serb dhe institucioneve të Republikës së Kosovës.

Gjithashtu, me ndërmjetësimin e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë, është iniciuar takimi i Ministrave të Shëndetësisë së Republikës së Kosovës dhe asaj të Serbisë.

**Kthimi i qëndrueshëm dhe integrimi** - Në kuadër të projektit “Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë, Faza 5” (BE - RRK 5), të cilin Ministria për Komunitete dhe Kthim bashkë financon me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë, dhe i cili implementohet nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) në 11 komuna, u mbajt seanca elektronike e Komitetit Drejtues të Projektit dhe u **aprovua ndërtimi i 62 shtëpive për të kthyerit dhe personat e zhvendosur**. Partneri implementues IOM, megjithëse masat kufizuese të shkaktuara nga pandemia e Covid-19, po zbaton procedurat për të filluar ndërtimin e shtëpive të përmendura. Në periudhën vijuese, pritet miratimi i kërkesave shtesë për ndërtimin e shtëpive.

**Aksioni i ndarjes së pakove të ndihmës gjatë pandemisë** - Është hartuar një *Program për mbrojtjen dhe ndihmën për më të rrezikuarit gjatë pandemisë së virusit Covid-19 në Kosovë*. Një pjesë e këtij programi kishte të bënte me aksionin nën moton “**Të fitoj jeta**”, gjatë të cilit 606 familje u ndihmuan në dy faza me pako ushqimore dhe higjienike.

## "Të filloj jeta" 606 familje

Në mënyrë të ngjajshme, në bazë të projektit “Kthimi dhe Ri-integrimi në Kosovë (RRK5), Faza 5”, Ministria për Komunitete dhe Kthim në bashkëpunim me Zyrën e Bashkimit Evropian në Kosovë bashkëfinancuan furnizimin dhe shpërndarjen e paketave të ushqimit dhe higjienës për 253 familje të kthyer, kryesisht të komunitetit rom, ashkali dhe egjiptian. Paketat e ushqimit janë shpërndarë me sukses

për 856 familje në 31 komuna, nga të cilat 3.374 banorë përfituan drejtpërdrejt (**46.6% serbë dhe 53.4% të tjerë - rom, ashkali, egjiptianët, shqiptarët, boshnjakët, goranët dhe turqit**).

**Procesi i Shkupit** - Në vitin 2014, Ministria për Komunitete dhe Kthim nisi një iniciativë rajonale me mbështetjen e OSBE-së dhe UNHCR-it, të gjitha me qëllim të gjetjes së zgjidhjeve të qëndrueshme për personat e zhvendosur nga Kosova. Që atëherë, institucionet përkatëse nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica janë takuar rregullisht përmes një procesi rajonal, i njohur më mirë si «Procesi i Shkupit». Ministri për Komunitete dhe Kthim, Ambasadori i OSBE-së në Kosovë dhe Shefi i Misionit të UNHCR-it në Kosovë zhvilluan një takim përmes një video konference dhe ranë dakord të **vazhdoj procesi i Shkupit përmes grupeve teknike të punës dhe forumeve të nivelit të lartë me akterët përkatës nga Prishtina, Beogradi, Shkupi dhe Podgorica**.

### Dënimi i krimeve të luftës

Puna e Qeverisë së Republikës së Kosovës në këtë drejtim është fokusuar në krijimin e institucioneve relevante për dokumentimin dhe arkivimin e krimeve të luftës. Për këtë qëllim është themeluar ekipi punues lidhur me përgatitjen e analizës për themelimin e **Institutit për Krime gjatë luftës në Kosovë**.

Një aspekt tjetër i rëndësishëm në këtë drejtim ka qenë edhe **puna në riorganizimin e brendshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore**. Me këtë rast është themeluar grupi punues për hartimin e rregullores për organizimin e brendshëm të Institutit të Mjekësisë Ligjore i cili ka përfunduar rregulloren e cila ka marrë mbështetjen edhe nga zyra e BE-së në Kosovë dhe pritet të miratohet.

### Rishikimi funksional i drejtësisë

Rishikimi funksional i sektorit të sundimit të ligjit synon të vendos një sektor të konsoliduar të sundimit të ligjit, ngritjen e besimit të qytetareve në sistemin e drejtësisë, zhvillimin ekonomik dhe integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian. Kjo nismë është ndarë në tri faza.

Pasi që faza II e RFSSL përfundoi me hartimin e më se 16 dokumenteve të politikave, Komiteti Drejtues ka miratuar

rekomandimet e dala nga dokumentet e politikave, ku u mundësua fillimi i Fazës III të RFSSL, hartimin e strategjisë sektoriale të Sundimit të Ligjit.

Përkundër gjendjes si rrjedhojë e pandemisë Covid 19, është duke u punuar në hartimin e strategjisë ku tanimë janë përfunduar dy kapituj të Strategjisë.

Bazuar në programin qeverisës, procesi i vetingut ka qenë prioritet gjatë kësaj periudhe (dhe vazhdon të mbetet i tillë), pasi që synon kthimin e besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. Qeveria e Republikës së Kosovës me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë **ka themeluar grupin e ekspertëve** për vetingun në sistemin e drejtësisë. Grupi ka për qëllim dizajnimin e procesit të vetingut dhe e parimeve udhëheqëse, skenarëve dhe elementeve të reformës së Vetingut në sistemin e drejtësisë. Grupi i ekspertëve është duke vazhduar punën pasi që mandati i tij është deri në fund të muajit maj.

Pas grupit punues, synohet formimi i grupit ministror dhe finalizimi i koncept dokumentit e pastaj projektligjit. Pra, deri në muajin dhjetor planifikohet miratimi i bazës ligjore. Në pjesën e parë të vitit 2021, planifikohet formimi i komisionit verifikues ndërsa në pjesën e dytë, verifikimi i niveleve më të larta hierarkike të sistemit

## Konsolidimi i drejtësisë civile dhe rregullimi i çështjeve pronësore

**Nisja e procedurave për anëtarësim në Konferencën e Hagës** – Për shkak të mos anëtarësimit në Konferencën e Hagës, është i vështirësuar zbatimi i së drejtës në çështjet që lidhen me rrëmbimin ndërkombëtar të fëmijëve, në aspektin civil, si dhe në konteste familjare dhe trashëgimore për qytetarët e Republikës së Kosovës. Prandaj, Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Ministrisë së Drejtësisë ka filluar procedurat për anëtarësim me qëllim të realizimit të të drejtave të qytetarëve të Kosovës dhe integritetit të Republikës së Kosovës në organizata rajonale dhe ndërkombëtare.

## Konsolidimi i drejtësisë penale

**Aktivitetet lidhur me bashkëpunimin Juridik Ndërkombëtar**

**kanë vazhduar me intensitet edhe gjatë kësaj periudhe** ku janë proceduar rreth 982 kërkesa dhe përgjigje për Ndhimë të Ndërsjellë Juridike Ndërkombëtare në çështje penale dhe civile. Ndër tjera, janë ekstraduar tre persona nga Kosova për në shtetet e BE-së dhe tre persona nga jashtë në Kosovë.

Përmes Zyrës së Përfaqësuesit Special të BE-së në Kosovë, është konfirmuar se Mekanizmi Ndërkombëtar i Tribunaleve penale (MICT), tani e tutje do i ekzekutojë kërkesat e Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës. Prandaj, **tani Kosova pritet të përfitojë shumë nga mbështetja e MICT-it**, veçanërisht përmes qasjes në materialin dëshmues të mbledhur nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë (ICTY).

Gjithashtu, ka pasur zhvillime pozitive në këtë fushë me shtetet që ende nuk e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Në këtë drejtim, është realizuar ekstradimi i parë nga Kosova në Greqi, i cili është vlerësuar lartë nga autoritetet helene. Po ashtu, Moldavia e ka ekzekutuar kërkesën e parë të prokurorëve kosovar lidhur me një rast për trafikim me qenie njerëzore, ndërsa Spanja e ka ekzekutuar një kërkesë të Gjykatës së Pejës në fushën civile, si dhe Ekuadori për herë të parë ka konfirmuar se është në ekzekutim e sipër të një kërkesë nga Republika e Kosovës lidhur me një rast për shpëlarje të parave.

Poashtu Ministria e Drejtësisë ka dërguar në Komision të Venecias draftin e kodit të procedurës penale ku së shpejti pritet opinioni i Venecias për të.

## Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit

Lufta kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit ka qenë dhe është prioriteti kryesor i kësaj Qeverie.

Në këtë drejtim Qeveria e Republikës së Kosovës qysh në mbledhjet e para të saj ka ndërmarrë veprime konkrete, *të cilat kishin për qëllim që të ndalonin humbjen dhe keqpërdorimin e parasë publike.*

Vendime të tilla ishin, zvogëlimi i kabinetit qeveritar; ulja e pagave përgjysmë për qeverinë në mbledhjen e mbledhjen e dytë të Qeverisë më 2 shkurt, pa prekur pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Qeveria ka ndërmarrë edhe një sërë vendimesh me qëllim të zbritjes së shpenzimeve dhe privilegjeve, përmes një sërë vendimesh tjera si ai për

për përdorimin e telefonave (fiks dhe mobil) në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Vendimi synon të racionalizoj shpenzimet e parasë publike për përdorimin e telefonave në Qeverinë e Republikës së Kosovës. Gjithashtu vendimi përcakton edhe të drejtën dhe shumën e lejuar të harxhimeve edhe në telefonin fikse në Qeverinë e Republikës së Kosovës e cila është shumë herë më e vogël se shumta e lejuar deri më tani.

Në programin qeverisës është theksuar se me prioritet të lartë, do të miratohet *Ligji për kontrollin dhe konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme*, si dhe do të themelohet një fond të veçantë për ruajtjen e aseteve të konfiskuara të përfituara në mënyrë të kundërligjshme të cilat do të shfrytëzohen për ngritjen kapaciteteve të institucioneve të sundimit të ligjit.

Për të arritur këtë Qeveria ka filluar menjëherë punën fillimisht përmes hartimit të

## Koncept dokumentit për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme

duke qenë se korniza ligjore aktuale nuk ka mundësuar luftimin efektiv të krimit të organizuar dhe korrupsionit.

Ligji i lartpërmendur parashihet të vendos barrën e provës tek personi i dyshuar, i cili vlerësohet se ka krijuar pasuri në shpërputhje me të hyrat që ka. Ndaj këtyre personave do të kërkohet justifikimi i pasurisë dhe në rast se kjo nuk realizohet, e njëjta konfiskohet dhe shkon në llogari të shtetit. Koncepti dokumenti për konfiskimin e pasurisë së pajustificueshme, i cili si rregull i paraprin projektligjit, është në finalizim e sipër dhe i njëjti në fund të muajit Maj do të publikohet për konsultime publike. Pas pranimit të komenteve dhe rishikimit të tyre, koncepti dokumenti do të procedohet për miratim në Qeveri.

Në mbledhjen e 21-të Qeverisë, është aprovuar Udhëzimi Administrativ për Përcaktimin e Procedurave për Shkatërrimin e Strukturave të Paligjshme i cili njëherit është dokumenti i parë që ka marr miratimin nga kabineti qeveritar. Qëllimi i këtij Udhëzimi Administrativ është përcaktimi i procedurave për aplikimin e mjetit juridik shkatërrimit të strukturave të paligjshme nga Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës lidhur me zbatimin e vendimeve të plotfuqishme të Komisionit për Kërkesa Pronësore dhe aktgjykimeve të Panelit të Ankesave pranë Gjykatës Supreme.

foto 3

Ministrja Haxhiu në takim me Kryetaren e Gjykatës Themelore në Prishtinë



# 03

# Zhvillimi ekonomik

Në kuadër të zhvillimit ekonomik, Qeveria e Republikës së Kosovës duke u bazuar në programin e Qeverisë dhe situatës me pandeminë COVID-19 ka ndërmarrë këto veprime:

- Themelimi i grupit punues për barrierat tregtare me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën i përbërë edhe nga zyrtarë dhe përfaqësues të odave;
- Hartimi i raportit të hollësishëm që identifikon barrierat dhe rekomandon masa për mënjanimin e tyre nga grupi punues për barrierat tregtare me Serbinë dhe Bosnjë-Hercegovinën;
- Qeveria ka miratuar vendimet lidhur me barrierat tregtare: së pari, ka liruar nga tarifat importin e lëndës së parë nga Serbia dhe Bosnja, dhe së dyti, ka hequr tarifën ndaj mallrave të Serbisë dhe Bosnjës dhe ka nisur zbatimin gradual të reciprocitetit si parim në marrëdhëniet tregtare me Serbinë tregtare me Serbinë ku bëhet fjalë për certifikata sanitare, fito-sanitare dhe veterinare, që i nënshtrohen kontrollit në kufi.
- Me qëllim të rimëkëmbjes ekonomike, qeveria në bashkëpunim të ngushtë me bizneset dhe përfaqësuesit e odave ekonomike, përmes **Këshillit Kombëtar të Zhvillimit Ekonomik** ka mbajtur takimin e parë për të zhvilluar politikat e mbarëvajtjes dhe rimëkëmbjes së ekonomisë gjatë dhe pas pandemisë *COVID-19*.

Në mbështetje të industrisë dhe bizneseve me kërkesë të Qeveria e Republikës së Kosovës, Zyra e BE-së në Kosovë ka zotuar ndihmën prej 160 milionë euro për rimëkëmbje të ekonomisë pas pandemisë *COVID-19*, gjithashtu zyra e BE-së ka miratuar projektin e IPA-s prej 5,5 milionë eurosh për të përkrahur dhe digjitalizuar ndërmarrjet e reja, të vogla dhe të mesme gjatë pandemisë;

**Janë regjistruar më se 2850 biznese të reja nga ARBK-ja gjatë periudhës 100 ditore**

## Politikat tregtare

Te **Politikat tregtare**, qeveria ka miratuar planin e veprimit për themelimin e pikës së vetme të kontaktit për tregtinë në shërbime. Pika e vetme e kontaktit është portal që informon bizneset dhe thjeshton krijimin dhe zgjerimin e tyre.

- Qeveria e Republikës së Kosovës e përfaqësuar nga MEPTINIS ka marrë pjesë në takimin e parë të Komitetit të Përbashkët për Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë me Turqinë,
- Gjithashtu për të siguruar lëvizjen e lirë të mallrave të domosdoshme gjatë pandemisë, Qeveria e Kosovës ka miratuar deklaratën e përbashkët të Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, CEFTA-s dhe Komitetit të Transportit të Evropës Juglindore për hapjen e korridoreve të gjelbra.

Qeveria përmes KIESA-së, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Agjencinë Austriake të Zhvillimit (ADA) për të krijuar masa lehtësuese për sektorin privat, veçanërisht në digjitalizim e bizneseve ku 31 biznese do të përfitojnë nga projekti i Bankës Botërore për certifikim produkti, standardizim të kompanisë dhe konsulencë biznesore.

Janë miratuar 86 standarde të reja, kryesisht për naftën dhe derivatet e naftës, ndërsa po shqyrton 173 standarde të tjera nga **Agjencia e Standardizimit** kurse janë në procedurat e prokurimit pajisjet e reja të metrologjisë nga **Agjencia e Metrologjisë**. Është përgatitur planin për reagimin emergjent dhe planin e rezervës për mallra ushqimore, farmaceutike dhe karburante.

**Anulimi i projektit të motivuar politikisht të Zonës Ekonomike në Malishevë, ku vetëm për shpronësim ishte planifikuar kostoja marramendëse prej 7 milionë euro.**



- Gjatë kësaj periudhe janë miratuar **10 akte nënligjore**, ku përfshihen rregulloret për sigurinë e makinerive, për pajisjet personale mbrojtëse, për produktet e parapaketuara, për shishet si enë matëse dhe për komisionin e ekspertëve të produkteve bujqësore dhe artikujve ushqimorë. Tutje, përfshijnë udhëzimet administrative për regjistrimin e padive kolektive të konsumatorëve, për regjistrimin e emrit zyrtar dhe emrit tregtar të bizneseve, për arkivin e ARBK-së dhe shërbimet e metrologjisë.
- Janë nxjerrë **8 urdhëresa** për menaxhimin e çmimeve, mbarëvajtjen e veprimtarive ekonomike, sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike e postare, sigurimin e furnizimit me naftë, si dhe mbrojtjen e burimeve të ujit.
- Janë kryer 393 inspektime në terren, janë trajtuar 72 ankesa të konsumatorëve dhe janë shqiptuar 39 gjoba nga inspektorati i tregut.

foto 4

Kryeministri Kurti në vizitë në kompaninë "Kosmonte Foods" me ministren Hajdari



## Tregu i punës dhe punësimi

Në mbështetje për Fondit Kosovar për Garanci Kreditorë duke pas qëllim rritjen e kapitalit të saj garantues, Qeveria ka nënshkruar marrëveshjen me KFW për grantin prej 6.5 milion euro; Qeveria gjithashtu ka nënshkruar edhe marrëveshjen e grantit në vlerë prej 7 milionë euro që ka për qëllim themelimin e “Fondit të Sfidave të Kosovës – Arsim Profesional dhe Trajnim”.

**Agjencia e Punësimit** është angazhuar në zbatimin e masës 15 të pakos emergjente fiskale, të miratuar me vendim të Qeverisë. Gjatë kësaj periudhe, ka regjistruar mbi 46,922 punëkërkuar (21,809 prej tyre gra) dhe 2,088 vende të lira të punës. Me përkrahje të donatorëve, Agjencia ka mundësuar regjistrimin e punëkërkuarve përmes internetit. Ka kryer edhe 912 ndërmjetësime mes punëdhënësve dhe punëkërkuarve. Është lidhur marrëveshje me Agjencinë Suedeze për Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) për një projekt prej 4 milionë eurosh për digjitalizimin e inspektimit.

# 4 mijë inspektime nga inspektorati i punës

## Bujqësia dhe zhvillimi rural

Duke marrë parasysh gjendjen ekzistuese në të cilën ka qenë sektori i Bujqësisë është hartuar analiza mbi këtë sektor ku ndër vërejtjet kanë dalë që menaxhimi jo i mirë me buxhetin nga viti në vit ka trashëguar borxhe të cilat kanë krijuar vështirësi në punën e bujqve dhe implikime në zbatimin e politikave bujqësore për zhvillimin e sektorit (borxh ndaj bujqve në vlerë prej 25,455,512 euro nga vitet 2018 dhe 2019).

- Gjatë këtyre 100 ditëve, qeveria i ka kushtuar rëndësi të veçantë planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit për Programin e Zhvillimit Rural dhe Programin e Pagesave

Direkte; ka rritur bashkëpunimin e munguar për vite të tëra me shoqatat e sektorit të bujqësisë dhe ka intensifikuar programet dhe projektet që tejkalojnë sfidat e bujqve dhe operatorëve ekonomik.

## Janë realizuar pagesat për 3,095 bujq, në vlerë prej 9,036,080 €.

- Ka filluar rikthimi i funksionimit normal të njësive administrative të Ministrisë, duke pezulluar dy (2) zyrtarë të lartë, sekretarin e përgjithshëm të MBPZHR dhe kryeshefin e Agjencisë për Zhvillimin e Bujqësisë të cilët janë me aktakuzë, kurse pesë (5) zyrtarë tjerë janë pezulluar nga udhëheqësit e tyre, pas konfirmimit të aktakuzës nga Prokurori i Shtetit. Gjithashtu nuk u janë vazhduar mbi 60 kontrata afatshkurta “marrëveshje mbi shërbime të veçanta” të cilat, në mënyrë të jashtëligjshme, ishin vazhduar nga një, tre apo gjashtë muaj deri në 10 vite rresht.

- Për herë të parë Qeveria e Republikës së Kosovës ka filluar hartimin e programit për aplikim online për Programin e Zhvillimit Rural (PZHR), për vitin 2020, duke mundësuar lehtësimin e procedurave për aplikimin e bujqve, rritjen e transparencës, mënjanimin e keqpërdorimeve të mundshme gjatë procesit të aplikimit dhe siguri e kontroll të aplikacionit sipas standardeve të ndjekura nga procedurat e parapara me pakon e akreditimit të AZhB-së.

- Qeveria ka zgjeruar skemën e sigurimeve bujqësore për bujqit tanë, përveç produktit të mjedrës kemi përfshirë edhe 5 produkte të tjera: molla, kumbulla, rrushi, dredhëza, dhe speci, produkte këto që bujqit tanë do përfitojnë nga primi i sigurimit bujqësor

- Ka filluar riorganizimi i Agjencisë së Zhvillimit të Bujqësisë, ku është priorizuar çështja e akreditimit të kësaj agjencie me qëllim të rritjes së transparencës në ndarjen e subvencioneve dhe granteve për të mundësuar menaxhimin e drejtpërdrejtë të fondeve të BE-së dhe si rrjedhojë qeveria ka rinisur diskutimet për ngritjen e kapaciteteve konkurruese





foto 5  
Ministri Mustafa në vizitë me bletarët e komunës së Podujevës

të të gjitha njësive në sektorin e bujqësisë në implementimin e projekteve në kuadër të programit IPARD III pas stagnimit të bashkëpunimit të viteve të fundit në mes Institucioneve qeveritare dhe Zyrës së BE-së në Kosovë.

- Pas situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, janë marrë masat për lehtësimin dhe menaxhimin e situatës me theks të veçantë mbrojtjen e bujqve dhe të vjelave pranverore janë marrë këto veprime: Vendimi për shtyrjen e përkohshme të afateve për implementimin e projekteve të granteve përfituese; pas kufizimit të lëvizjes së lirë, janë marrë masa lehtësuese për bujqit me qëllim që tu krijohet mundësia e punimit të tokës me orar të zgjatur 06:00–20:00; është siguruar korridori i furnizimit me ushqim për blegtorinë dhe shpeztarinë, duke evituar kështu një krizë për këta dy sektorë; është marrë vendim për shtyrjen e përkohshme të afateve procedurale për marrjen dhe vazhdimin e lejeve dhe

licencave për zbatimin e legjislacionit primar dhe sekondar që ndërlidhen me fushën e Hortikulturës, Produkteve për Mbrojtjen e Bimëve, Plehrave, Mbrojtjes së Bimëve, Farërave, Blegtorisë, Pylltarisë, Verëtarisë dhe Shërbimeve Këshilluese për Bujqësi.

**Në aspektin e Sigurisë së ushqimit**, janë draftuar dhe dërguar për procedurë të mëtejme **7 akte nënligjore dhe 8 akte tjera janë në procedurë harmonizimi dhe plotësim ndryshimi** kurse në aspektin e shëndetit publik vazhdon përpilimi i Procedurave Standarde të Operimit (PSO), sipas Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, monitorimi i kontrolleve zyrtare dhe plani i mbetjeve në ushqim, monitorimi i certifikimit të produkteve ushqimore, mbështetja dhe monitorimi institucional i ndërtimit të fabrikës së trajtimit të nënprodukteve shtazore.



## Teknologjia e informimit dhe komunikimit (TIK)

Në aspektin e **Telekomunikacioni dhe TIK-u**, Qeveria ka nënshkruar kontratën e projektit të Qendrës së Ekselencës Digjitale në Parkun e Inovacionit dhe Trajnimit në Prizren ku do të furnizoj qendrën me pajisje të TI. Gjithashtu qeveria është duke punuar për të shtrirë internetin në 50 fshatrat e fundit të vendit. Duhet cekur se Qeveria e Kosovës përmes institucioneve të saja ka aplikuar për anëtarësimin e Kosovës në rrjetin pan-evropian të të dhënave për arsim dhe hulumtim GÉANT.

foto 6

Ministrja Hajdari / Digjitalizimi nuk pyet për kufijtë, mundëson rrjedhën e ideve dhe projekteve.

## Zhvillimi i balancuar rajonal

**Qeveria e Kosovës ka lansuar Programin për Zhvillim Rajonal të balancuar** (kategoria e investimeve kapitale për komuna), si dhe Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (kategoria e përkrahjes së bizneseve PZHRB 2020) duke përgatitur dhe aprovuar Udhëzuesin për realizimin e Programit për Zhvillim Rajonal për vitin 2020 si dhe Udhëzuesin për kategorinë e investimeve kapitale.



04

# Arsimi dhe shkenca

Qeveria e Kosovës si hap fillestar ka realizuar analizën në sistemin arsimor ku janë gjetur shumë parregullësi. Kështu, në MASHTI janë evidentuar mangësi menaxheriale, shkelje procedurale, mungesë performace dhe mungesë e funksionimit të ministrisë si pasojë e keqqeverisjes dhe organogramit jo-adekuat. Për të rikthyer funksionalitetin dhe efikasitetin, përmes një organogrami funksional, MASHTI është duke punuar rreth plotësim-ndryshimit të rregullores për organizim të brendshëm të Ministrisë.

Më tutje, janë ndërmarrë disa veprime për të ndaluar proceset e kundërligjshme të cilat kanë dëmtuar sistemin arsimor. Në këtë drejtim, është bërë shfuqizimi i Udhëzimit Administrativ (Nr. 03/2018) për Gjuhët e Huaja në Programin e Studimit të Ciklit të Dytë dhe të Tretë i cili ishte aprovuar në mënyrë të kundërligjshme. Janë reduktuar ndjeshëm shpenzimet për mallra dhe shërbime dhe janë mënjanuar nga buxheti projekte disa milionëshe të cilat kanë qenë të përfshira në kundërshtim me legjislacionin dhe procedurat në fuqi.

Është bërë përzgjedhja e Drejtorit të Agjencisë Kosovare për Akreditim ku Ministria është përgëzuar nga Ambasada Britaneze në Kosovë, si dëshmi për depolitizimin e agjencive të pavarura dhe fillimin e rikthimit të autonomisë së agjencisë.

Për sigurimin e mësimnxënies/mësimdhënies më të lehtë dhe efikase, janë themeluar grupet e veçanta të cilat sigurojnë cilësinë e kurrikulave dhe teksteve shkollore. Pra janë formuar:

- Grupi Punues për hartimin e Ligjit për Tekste Shkollore
- Këshilli i Ekspertëve për Programe dhe Tekste Shkollore
- Komisioni Shtetëror për Maturën

Qeveria e Kosovës është kujdesur që një rol i veçantë t'i kushtohet shkencës dhe inovacionit, përmes përfundimit të Raportit të Vlerësimit të Planit Strategjik të Arsimit në Kosovë 2017–2021, plan ky që kishte ngecur. Gjithashtu, është përgatitur Granti Specifik për Arsim.

Qeveria ka aprovuar propozim-vendimin për kompensimin e dëmeve në infrastrukturën shkollore, të shkaktuar nga erërat e forta dhe moti i ligë në Komunën e Istogut dhe Pejës.

## Rritja e cilësisë së mësimdhënies në arsimin parafillor, fillor dhe të mesëm

Gjatë kësaj periudhe, me qëllim të përgatitjes dhe aftësimin e nxënësve dhe studentëve për jetën dhe tregun e punës janë destinuar më shumë përkrahje buxhetore për objekte parashkollore, modernizim të infrastrukturës në të gjitha nivelet (më shumë laboratore, mjete konkretizimi, literaturë fizike e elektronike, digjitalizim të materialeve e infrastrukturës mësimore), ndërtim të shkollave të reja, sallave të edukatës fizike, përmirësim të nyjeve sanitare, etj.

Gjithashtu, janë pranuar dorëshkrimet për tekste e reja shkollore për klasat 3, 8, 12 si dhe për dorëshkrimet të cilat nuk janë vlerësuar pozitivisht nga recensentët nga procesi i vitit të kaluar (2019). Ndërkohë, është në proces përzgjedhja e recensentëve për vlerësimin e dorëshkrimeve.

Në komunën e Kamenicës është arritur normalizimi i procesit mësimor, pas reaktionit të nxënësve dhe prindërve si pasojë e reformës së Kryetarit të Kamenicës për riorganizimin e procesit mësimor.

## Menaxhimi i aktiviteteve për parandalimin e COVID-19 –

Duke qenë të vetëdijshëm për mundësinë e përhapjes së shpejtë të kësaj pandemie në institucionet shkollore, me kohë është kërkuar rritja e higjienës në shkolla, është mbajtur komunikim i vazhdueshëm me Drejtoritë Komunale të Arsimit (DKA-të) dhe në bashkëpunim me Institutin Kombëtar për Shëndetin Publik (IKSHPK), janë dërguar udhëzime tek të gjitha institucionet arsimore për zbatimin e masave për parandalimin e përhapjes së virusit. Në përputhje me Planin Kombëtar për Reagim ndaj COVID-19, të aprovuar nga Qeveria e Kosovës me 10.03.2020, është përgatitur një plan i detajuar i veprimit që është shpërndarë tek të gjitha Komunat/DKA-të, shkollat dhe institucionet edukative në vend.

Menjëherë pas ndërprerjes së procesit mësimor (me 12.03.2020) për shkak të pandemisë COVID-19 kanë filluar përgatitjet intensive për realizimin e mësimin nga distanca në bashkëpunim me OJQ dhe kompani të IT-së të cilët kanë ofruar mbështetje në baza vullnetare. Në këtë drejtim, është konsoliduar bashkëpunimi i ngushtë me Komunën e Prishtinës (DKA) dhe shkollën “Qamil Batalli” në Prishtinë si dhe shkollën “Emin Duraku” në Prizren të cilat kanë ndihmuar



foto 7  
Kryeministri Kurti në vizitë te Shkolla Model  
"Qamil Batalli" në Prishtinë.

në jetësimin e këtij projekti. Programi i mësimin në distancë është realizuar në përputhje me planprogramet mësimore të Republikës së Kosovës.

**E-mësimi** - Me 23 mars 2020, ka filluar transmetimi i mësimin në distancë në RTK, si dhe është lansuar kanali zyrtar i MASHTI-t në YouTube. Fillimisht për klasat 1-5, për lëndët gjuhë amtare dhe matematikë, për t'u zgjeruar brenda një jave edhe për klasat 6-9.

Me 6 prill, MASHTI filloi transmetimin e përmbajtjes mësimore në distancë me orar të ngjeshur duke përfshirë më shumë se 70% të lëndëve mësimore. Pjesëmarrja e nxënësve është prej më shumë se 90 %.

Me 16 prill, në bashkëpunim dhe me përkrahje të "UNICEF" dhe "Save the Children", MASHTI ka lansuar platformën "Edukimi në Distancë – Kujdesi, Zhvillimi dhe Edukimi në

fëmijërinë e hershme për moshën 0-6 vjeç". Me 18 prill, janë përfunduar video-xhirimet në shkollën "Qamil Batalli", në Prishtinë ku janë prodhuar 1800 video-njësi mësimore. Në fillim të muajit prill, MASHTI filloi prodhimin e video-ligjëratave edhe në gjuhë turke dhe në gjuhën boshnjake, këto xhirime ende po vazhdojnë në shkollën "Emin Duraku" në Prizren.

Gjatë kësaj kohe janë bërë përpjekje sa i përket pajisjes së fëmijëve (familjeve) që kanë mungesë të pajisjeve elektronike për ndjekjen e mësimin në distancë ku është ofruar mbështetje e rëndësishme nga donatorët të ndryshëm sikurse: Elkos Group, Kompania Ecolog, komunat dhe donatorët individualë, Banka Botërore, GIZ-i gjerman, etj.

Në bashkëpunim dhe me mbështetje të "Save the Children" është lansuar platforma për mësimin gjithëpërfshirës për fëmijët me nevoja të veçanta.



## Arsimi dhe aftësimi profesional

Lidhur me këtë fushë, është në prag të nënshkrimit marrëveshja me Bankën Gjermane për Zhvillim (KfW) për projektin “Fondi i Sfidave të Kosovës - Arsimit Profesional dhe Trajnimi” në shumë prej 7 milionë euro në mbështetje të Arsimit dhe Aftësimi Profesional në Kosovë.

## Arsimi i lartë

Në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve, është ndarë më shumë buxhet për adresimin e kërkesave për projekte të reja kërkimore, inovacione e investime në shkencë e dije. Poashtu, është rritur buxheti në kategorinë e bursave për të përmirësuar situatën jo të mirë nga viti i kaluar, ku ish-kabineti kishte anuluar dhënien e bursave për studentët elitare.

Aktualisht, është në fazë të avancuar procesi i arritjes së marrëveshjes me SHBA-të, për themelimin e Komisionit Kosovë-SHBA për bursat Fullbright. Një arritje e konsiderueshme kjo për fuqizimin e bashkëpunimit ndërmjet Kosovës dhe SHBA-së në fushën e arsimit të lartë. Ministria është në fazën finale të arritjes së memorandumit të bashkëpunimit në fushën e arsimit me Republikën e Çekisë. Janë në proces të vazhdimit marrëveshjet për bashkëpunim me partnerë tjerë si GIZ-i gjerman, Qeveria e Luksemburgut, ADA Austriake, Caritasi Zvicëran etj.

Gjithashtu, është në fazën finale të harmonizimit memorandumit të bashkëpunimit me Hungarinë, përmes së cilit, Qeveria e Hungarisë do të zgjerojë skemën e bursave për studentët kosovarë, nga 50 bursa sa kanë qenë deri tani, në 75 të tilla, për tri ciklet e studimit (bachelor, master dhe doktoratë).

foto 8

Ministrja Bajrami / Lansimi i projektit strukturor Erasmus + “Ngritja e kulturës kërkimore në arsimin e lartë në Kosovë (ResearchCult)”.



05

# Shëndetësia

Fokusi i Qeverisë në fushën e shëndetësisë ka qenë në sigurimin dhe përmirësimin e shëndetit të qytetarëve, avancimin e cilësisë, sigurisë, efektivitetit, leverdisë dhe efikasitetit të ofrimit të shërbimeve shëndetësore, riorganizimin e sektorit shëndetësor dhe financimit të qëndrueshëm të tij.

Të përballur me pandeminë më të madhe në shekujt e fundit **COVID-19**, mbi 90% të aktiviteteve dhe ndërhyrjeve të kësaj Ministrie në këtë 100-ditësh kishin të bëjnë direkt apo tërthorazi me menaxhimin e kësaj pandemie. Për shkak të mungesave elementare (masat mbrojtëse, barnave, materialit shpenzues, paisjeve) si dhe pa bazën ligjore adekuate, në këtë përballje Ministria e Shëndetësisë është ballafaquar me vështirësi të shumta.

**Masat qeveritare, ndërministrore dhe ministrore** - Me vendim të Ministrit të Shëndetësisë, me datë 27 shkurt 2020 është themeluar Komiteti për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me COVID-19. Me 5 mars, është themeluar Grupi Punues për hartimin e Planit të Veprimit si derivat i planit për gatishmëri dhe reagim për coronavirusin COVID 19, i cili është miratuar nga Qeveria me 10 mars.

Menjëherë pas shpalljes së pandemisë nga OBSH me 11 mars 2020, me kërkesë të Ministrisë së Shëndetësisë, Qeveria e Republikës së Kosovës, mes shumë masave të tjera, ka marrë vendim për:

**1.**

Ndërprerjen e procesit edukativo-arsimor në institucionet arsimore publike dhe private në të gjitha nivelet

**2.**

Pezullimin e përkohshëm të udhëtimit ajror dhe tokësor.

Ministria e Shëndetësisë ka bërë thirrje publike AKK-së (Autoriteti Kosovare i Konkurrencës) dhe Policisë së Kosovës për krime ekonomike për hetimin e çmimeve të rritura të produkteve esenciale për luftimin e pandemisë, pas konfirmimit nga ana e komisionit për hulumtimin e çmimeve të produkteve dhe pajisjeve.

Në nivel të Qeverisë merret vendim për kufizimin e hyrje-daljeve në komunat ku u regjistruan rastet e para.

● **Më 16 mars 2020 është krijuar Qendra Operative Emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë për operim gjatë 24 orëve.** Kjo qendër pasohet nga qendrat operative ministrore dhe komunale.

● **Më 18 mars 2020, Qendra e Studentëve është caktuar si hapësirë karantine.** Në të janë pranuar 1180 persona.

● Pas shpalljes së gjendjes së emergjencës shëndetësore me 15 mars, Qeveria obligon institucionet të veprojnë konform Planit të Reagimit Kombëtar. Bazuar në këtë plan, grupi ndërinstitucional merr vendim që: personat që hyjnë përmes pikës kufitare, pas kontrollit mjekësor, të dërgohen në karantinë.

● Gjithashtu merret vendim për caktimin e qendrës për të huaj në Vranidoll si hapësirë karantine (26 mars), për ndërprerjen e menjëhershme të transportit urban në të gjitha komunat (31 mars).

Gjatë muajit prill, me rekomandim të IKShPK, Ministria e Shëndetësisë për të parandaluar përhapjen e infeksionit dhe me qëllim të ruajtjes së shëndetit publik, si dhe në përgjigje ndaj vendimeve të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me vendimet e mëhershme të Qeverisë, fillon me marrjen e vendimeve për kufizimin e hyrje-daljeve, shpalljen e vatrave të përhapjes së infeksionit dhe futjen e komunave specifike në karantinë.

Me datë 30 prill 2020 Ministria e Shëndetësisë, pas 14 ditëve të pushimit të plotë të aktiviteteve ekonomike, ka prezantuar hapat graduale të zbutjes së masave restriktive të imponuara për parandalimin dhe luftimin e pandemisë COVID-19.

Hapja është paraparë në tre (3) faza, me fazën e parë të nisur së zbatuari me disa lehtësime që nga 4 maji. Faza e dytë parashihet të fillojë me 18 maj, ndërsa faza e fundit fillon me 1 qershor. Ndërmjet fazave të paracaktuara do të bëhet rivlerësimi i situatës epidemiologjike si tregues më i besueshëm i mundësisë/nejvës për zbutjen apo rikthim të masave të fazës vijuese.



## Riorganizimi i sektorit shëndetësor

**Me qëllim të Koordinimit më të mirë ndërinstitucional** për luftimin e Pandemisë Covid-19- është krijuar Qendra Operative Emergjente në Ministrinë e Shëndetësisë më 16 mars 2020 dhe Qendra për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve Ngjitëse në IKShPK si dhe është realizuar koordinimi ndërinstitucional përmes Qendrës Operative të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të cilat kanë mundur aktivizimin dhe koordinimin e plotë dhe efektiv të Ministrive përkatëse si dhe organizmave të ndryshëm përgjegjës për menaxhimin e emergjencave si MASHTI, MPJD, MIA, MEPTINIS, MFT, MKRS, Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave. Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave.

Për menaxhimin e situatës dhe detektimin e rasteve të dyshimta, si dhe përcjelljen e dinamikës së sëmundjes është mundur përmes:

**9314 mostra**  
**861 raste pozitive**  
**561 të shëruar**

- Qendrës së thirrjeve në të cilën pranojnë 200 deri në 300 thirrje brenda ditës;
- Funkcionalizmit të sistemit të informimit për COVID-19 Kosova health;
- Zgjerimi i kapaciteteve laboratorike dhe furnizimit;
- Janë testuar gjithsej 9314 mostra të dyshimta në virusin SARS-CoV-2, ku pozitiv kanë rezultuar 861 raste, janë regjistruar 28 raste me fatalitet dhe janë shëruar 561 raste;
- Futja e të dhënave në sistemin elektronik të dizajnuar për COVID-19 “Kosova Health”, përpunimi dhe analiza e të dhënave, përgatitja e raporteve të rregullta ditore për ecurinë e situatës epidemiologjike me COVID-19;
- Ekipet e IKShPK dhe Qendrat e Mjekësisë Familjare kanë përcjellë me vëmendje situatën epidemiologjike me Coronavirus në pikat hyrëse tokësore dhe aeroportin ndërkombëtar “Adem Jashari”, duke e bërë depistimin e të gjithë udhëtarëve dhe evidentimin me lista kontrolluese.

Rastet aktive të COVID-19 në Kosovë

Rastet aktive = (të infektuar) – (të shëruar) – (të vdekur)







Foto 9  
Kryeministri me  
Ministrin Vitia në vizitë  
te Klinika Infektive

Rritja (%) e rasteve të infektimit dhe shërimit të COVID-19  
sipas mesatares 7 ditore



## Përmisimi i shërbimeve shëndetësore

**Shërbimet shëndetësore** - Me kërkesë të Ministrisë, është funksionalizuar bordi i SHSKUK nga ana e Qeverisë. Janë rritur kapacitetet për pacientë të infektuar dhe të dyshuar me COVID-19. Treqind shtretër nga Klinika Infektive, e Pulmologjisë dhe e Dermato-venerologjisë janë rezervuar për personat e dyshuar dhe të infektuar me COVID-19. Është transformuar objekti në ndërtim i Mjekësisë Sportive në njësi të kujdesit intensiv pranë QKUK, për trajtimin e rasteve që kërkojnë reanimin dhe ventilim të asistuar. Gjithashtu, është përgatitur plani për zgjerim të kapaciteteve të këtyre hapësirave.

— Në SHSKUK në periudhën e punës (janar - maj 2020), u ofruan 1.9 milionë shërbime, 181,012 të shërbimeve ishin ditë shërimi në nivel të Kosovës me gjithsej 37,044 pacientë të shtrirë;

— Janë kryer 10,308 operime në nivel të ShSKUK-së, 369,648 shërbime ambulantore;

— Janë kryer 856,390 shërbime (parametra) laboratorike për 109,809 pacientë;

— Janë kryer 4,429 lindje në të gjitha njësitë e ShSKUK-së;

— Janë realizuar 31,956 dializa, ndërsa mesatarja e ditëve të shërimit për pacient ishte **4.89 ditë**. Shfrytëzimi mesatar i kapaciteteve në SHSKUK është 52.62%;

— Janë rritur kapacitetet për pacientë të infektuar dhe të dyshuar me COVID-19

foto 10

Kryeministri Kurti me Ministren Redžepi në vizitë te komunat për të diskutuar menaxhimin e pandemisë COVID-19.





- *Përgatitja e planit për zgjerimin e mëtutjeshëm të kapaciteteve, deri në 100 shtretër në këto hapësira, për përdorim në rast nevoje;*
- *Ngritja e kapaciteteve për dializë në QKUK dhe Spitalin e Prizrenit për pacientët në hemodializë, që janë të dyshuar dhe të konfirmuar me Covid 19, duke instaluar tre aparate të hemodializës me aparaturën përcjellëse në Kujdesin Intenziv të mjekësisë Sportive në QKUK;*
- *Modifikimin e Repartit të Hemodializës në Spitalin e Prizrenit duke funksionalizuar Qendrën e Hemodializës në Rahovec;*
- *Është funksionalizuar laborator i mikrobiologjie klinike në Klinikën Infektive në mbështetje të qeverisë italiane;*
- *Është mundësuar qasja në sistemin BARNATARI nga shtëpitë dhe në këtë mënyrë personeli i AKPPM-së ka kryer shërbimet online.*

**Inspektimet** - Inspektimet tematike për monitorimin e zbatimit të vendimeve dhe qarkoreve informuese të nxjerra për parandalim dhe kontroll të infeksioneve me COVID-19 në institucionet shëndetësore si dhe përdorimi i masave mbrojtëse nga punëtorët shëndetësor;

Gjatë inspektimeve për periudhën 04 shkurt- 8 maj 2020 janë marrë 10 vendime të shkallës së I-rë dhe 21 vendime të shkallës së II-të.

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes **Agjencionit të Ushqimit dhe Veterinarisë** ka nxjerrë 147 vendime të ndryshme sipas kompetencave. Për shkak të pandemisë së shkaktuar nga virusi COVID-19, stafi i Agjencisë ka marrë pjesë në grupet nacionale-shtetërore për menaxhimin e pandemisë si dhe janë rritur aktivitetet inspektuese, në përgjigje të kësaj situatë sipas fushë-veprimtarisë së Agjencisë.

Në aspektin e shëndetit publik vazhdon përpilimi i

Procedurave Standarde të Operimit (PSO), sipas Sistemit të Menaxhimit të cilësisë, monitorimi i kontrolleve zyrtare dhe plani i mbetjeve në ushqim, monitorimi i certifikimit të produkteve ushqimore, mbështetja dhe monitorimi institucional i ndërtimit të fabrikës së trajtimit të nënprodukteve shtazore. Gjithsej janë aprovuar 8 dhe regjistruar 112 operatorë të biznesit me ushqim. Janë dhënë 226 leje importi (kafshë të gjalla dhe ushqim për kafshë).

Inspektorati i AUV ka vazhduar me kryerjen e kontrolleve zyrtare (inspektimeve, monitorimeve dhe mostrimit) ku janë kryer gjithsej 14,231 kontrolle dhe janë marrë 1,897 mostra; asgjësuar rreth 154,000 kg produkte ushqimore; janë lëshuar 628 Certifikata Eksporti dhe 338 Certifikata të brendshme.

Laboratori i Ushqimit dhe Veterinarisë ka pranuar dhe testuar gjithsej 4,995 mostra me referencë nga Plani i Kontrolleve Zyrtare, Monitorimi i Mbetjeve në Ushqim, Monitorimi i Sëmundjeve të Kafshëve, Programi i Transparencës dhe Neutralitetit të Mostrave të Qumështit.

Janë draftuar dhe dërguar për procedurë të mëtejme **7 akte nënligjore dhe 8 akte tjera janë në procedurë harmonizimi dhe plotësim-ndryshimi**. Janë përgatitur 57 propozim vendime, 36 kërkesa për procedurë të kundërvajtjes, 3 kërkesa për Avokaturën Shtetërore.

**338**  
Certifikata të brendshme

**628**  
Certifikata eksporti

# 06

# Politik sociale

Qeveria e Republikës së Kosovës përmes Pakos Emergjente Fiskale ndër të tjera ka përkrahur edhe përfituesit e të gjitha skemave sociale dhe pensionale. Në këtë drejtim përmes vendimeve të Qeverisë është përcaktuar rritja prej 30 euro për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore me vlerë deri në njëqind (100) euro. Pagesa shtesë në vlerë prej tridhjetë (30) euro në muaj për të gjithë përfituesit e skemave sociale dhe pensionale që marrin pagesë mujore në vlerë më të ultë se njëqind (100) euro, për muajin prill, maj dhe qershor, me kusht që të jenë përfitues vetëm të një skeme; si dhe rikthim në listat e përfituesve për përfituesit që për shkak të mos-paraqitjes apo mos-vlerësimit në periudhën janar – mars 2020, nuk u janë rinovuar të drejtat e tyre. Kjo masë është në vlerë deri në trembëdhjetë milionë euro (13,000,000)

Pagesa e asistencës mujore në vlerë prej njëqind e tridhjetë (130) euro për qytetarët me kushte të rënda sociale, të

lajmëruar si të papunë në institucionin kompetent, që nuk janë përfitues të asnjë të hyre mujore nga buxheti i Kosovës, për muajin prill, maj dhe qershor, në vlerë deri në tre milionë (3,000,000) euro;

Pagesa e dyfishtë e vlerës së skemës sociale për të gjithë përfituesit të skemave sociale për muajin prill dhe maj, masë kjo në vlerë deri në shtatë milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë (7,650,000) euro, përfshirë këtu edhe pagesën e realizuar për muajin mars;

Kjo me qëllim të ofrimit të ndihmës së këtyre kategorive në përballje me pandeminë COVID-19.

foto 11

Vizita e Kryeministrit në Shtëpinë e Personave të Moshuar në Prishtinë.





07

# Mjedisi dhe infrastruktura

Në kuadër të zotimeve të theksuara në Programin e Qeverisë 2020–2023, Qeveria është përkushtuar në ruajtjen e mjedisit dhe zhvillimin e infrastrukturës. Për t'i arritur këto, në 100 ditë e para, Qeveria ka iniciuar dhe ka marrë një sërë veprimesh dhe masash.

Për **ruajtjen e mjedisit**, ruajtjen e cilësisë së ujit, përmirësimin e shërbimeve ujore dhe zhvillimin e ujërave të zeza, Qeveria ka marrë veprimet dhe masat si në vijim:

Me qëllim të përmirësimit të sistemit të hidrocentraleve në Kosovë, është filluar analizimi i gjendjes aktuale dhe ka filluar hartimin e planit për përmirësimin e saj.

- Duke u thirrur në Ligjin për Ujërat e Kosovës dhe duke u mbështetur në Vendimin e Qeverisë për zonat e mbrojtura në Liqenin e Badovcit, është obliguar Komuna e Prishtinës që të anulojë vendimin për kushtet ndërtimore për rastin e lagjes në afërsi të Liqenit të Badovcit.

## Anulimi i Vendimit për kushtet ndërtimore për rastin e lagjes në afërsi të Liqenit të Badovcit.

- Me qëllim të përmirësimit të ujitjes së tokave, është miratuar masterplani i ujitjes dhe korniza për investime, i financuar nga Banka Botërore, që shërben si bazë për investime në ujitje dhe që propozon një listë të investimeve prioritare në vlerë prej 400 milionë euro, që mbulon 57,000 ha.

- Është pranuar projekti i fizibilitetit për kanalin e Lepencit dhe ndërtimin e digave në Firajë dhe Shtime, i cili zgjatë 3 vite (2023–2025) dhe ka vlerën 49.3 milionë euro.

- Është finalizuar dhe negociuar suksesshëm projekti i Bankës Botërore “Programi Nxitja dhe Lehtësimi i Mundësive për Sigurinë e Ujit” – kredi në vlerë prej 25.1 milionë euro.

- Në bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane, është filluar përgatitja e projektit 5 vjeçar “Përmirësimi i rezistencës ndaj klimës në sektorin e shërbimeve të ujit” (Improving Climate Resilience in Water Services Sector) në vlerë prej rreth 6 milion euro.

- Është bërë finalizimi i projektit Zviceran për Menaxhimin e

Integruar të Resurseve Ujore në Kosovë dhe është dakorduar nisja e fazës së parë 4 vjeçare në vlerë të 8.7 milionë CHF (nga tri faza gjithsej në vlerë 20 milionë CHF) që synon hartimin e planeve të pellgjeve lumore të Ibrit, Lepencit dhe Moravës së Binçës. Në kuadër të këtij projekti, është paraparë themelimi dhe zhvillimi i Autoritetit të Rajonit të Pellgjeve Lumore, si dhe zhvillimi i kapaciteteve të Inspektoratit dhe Institutit Hidrometeorologjik të Kosovës.

- Është bërë ndërmjetësimi mes WBIF (EU) dhe GIZ (Gjerman) për evitimin e dyfishimeve në projektet për vlerësimin paraprak të rrezikut nga përmbytjet në pellgun (VPRrP) e Drinit të Bardhë, dhe është bërë dakordimi me WBIF që fondet e tepruara të riorientohen në kompletimin e VPRrP për tërë pellgun e Ibrit nga nën-pellgu i Sitnices, kompletimin e pellgut të Plavës, si dhe sigurimin e fondeve për pellgun e Moravës së Binçës.

- Me qëllim të zhvillimit të ujërave të zeza, është nënshkruar marrëveshja (nga ana e MEPTINIS, MIA dhe KRU Prishtina) me Qeverinë Franceze, për projektin e impiantit të trajtimit të ujërave të zeza në Prishtinë, që do të përfshijë edhe komunat e Fushë Kosovës dhe Obiliqit

- Është aprovuar Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes për Hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe BERZH, për Projektin e Zhvillimit të Ujërave të Zeza në Gjilan.

Në kuadër të zhvillimit të **infrastrukturës**, qeveria ka marrë veprimet dhe masat si në vijim:

- Pas gjetjes së parregullsisë, është shfuqizuar vendimin e Qeverisë së kaluar nr. 10/105, të datës 28.05.2019, për zgjatjen e afatit të përfundimit të kontratës për ndërtimin e Autostradës R6 “Arben Xhaferi” nga data 01.06.2019 deri me datën 01.12.2020, e cila parashihte punë shtesë prej mbi 50 milion euro.

- Pas gjetjes së parregullsisë, është anuluar tenderi 110 milionësh për Autostradën Prishtinë – Gjilan, i shpallur nga Qeveria e kaluar pa miratim buxhetor, në kohën e tranzicionit qeveritar.

- Për shkak të dinamikës së ulët të punës, është ri-organizuar puna në projektin e urës së Veternikut në Prishtinë, me ç’rast është përfunduar pothuajse dy muaj para afatit të paraparë.




foto 12

Përfundimi i punimeve në rrugën në Veternik, Prishtinë.

- Është shtuar dinamika dhe puna është organizuar ashtu që ndërtimi i rrugës N2 (Prishtinë – Mitrovicë) të përfundojë në Korrik 2021. Është hartuar Plani i Punës dhe punimet po vazhdojnë. Meqenëse shpronësimi i pronave të paluajtshme ishte një prej pengesave kryesore të projektit, është iniciuar vendimi për shpronësimin e pronave të paluajtshme të cilat preken nga ndërtimi i rrugës nacionale N2, Prishtinë – Mitrovicë, që është votuar nga Qeveria.
- Është shtuar dinamika e punës edhe në projektet si ndërtimi i rrugës Kiev - Zahaq, i cili financohet me kredi nga BERZH dhe EIB, ndërtimi i rrugës Prishtinë – Podujevë dhe autostrada Prishtinë – Gjilan.
- Ndonëse për shkak të pandemisë nuk është lejuar fillimi i projekteve të reja, është shtuar dinamika e punëve dhe koncentrimi i resurseve në mirëmbajtjen e rrugëve dhe në

projektet aktuale të ndërtimit të rrugëve. Mirëmbajtja e rrugëve ka funksionuar gjatë tërë kohës së pandemisë dhe në shumë raste është bërë edhe dezinfektimi i rrugëve nacionale.

- Në kuadër të koordinimit me donatorë, MIA ka marrë pjesë në dizajnimin dhe negocimin e projektit FLOWS (në vlerë prej 28.45 milionë euro), i financuar nga Banka Botërore. Ky projekt është në fazën e nënshkrimit dhe zbatimi i tij do të fillojë së shpejti.
- Është shtuar vëllimi i në projektet me Komisionin Evropian, specifikisht projekti SIGMA, Green Deal, si dhe fondet IPA 20 dhe IPA 21.
- Është vazhduar koordinimi i punëve në projektet me GIZ dhe me SDC-në zvicerane, por gjithashtu edhe me JICA në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Duhet theksuar se, pas shpalljes së pandemisë COVID-19, është marrë vendimi për pezullimin e përkohshëm të linjave të udhëtimit ajror dhe tokësor me vendet tjera. Pas këtij pezullimi, është shfaqur nevoja emergjente për organizimin e fluturimeve të veçanta për të ri-atdhesuar qytetarët e Republikës së Kosovës, që kishin nevoja emergjente të kthehen në vend. Për këtë, janë organizuar mbi 10 fluturime me leje të veçantë nga MIA, ku janë ri-atdhesuar mbi 1000 qytetarë të Republikës së Kosovës. Ky proces po vazhdon me sukses edhe këto ditë. Në anën tjetër, është mbajtur kontakt i vazhdueshëm me të gjitha ministritë e transportit të vendeve fqinje, por edhe me autoritetet evropiane, në mënyrë që transporti i mallrave të funksionojë pa probleme.

foto 13

Kthimi i qytetarëve të evidentuar nga ambasadat tona jashtë vendit.

- Në buxhetin e këtij viti janë përfshirë projektet kryesore si ndërtimi i rrugës Prishtinë – Podujevë, Prishtinë–Mitrovicë, Kievë–Zahaq dhe autostrada Prishtinë - Gjilan
- Është dyfishuar numri i stafit të mbikqyrësve në departamentin rrugor. Deri më tani, një mbikqyrës ka pasur në menaxhim me dhjetëra projekte.



08

# Energjia dhe miniera



Sa i përket sektorit të **energjisë**, Qeveria ka marrë këto veprime dhe masa:

- Është vëzhguar votimi i marrëveshjes së kyçjes mes operatorit të transmisionit KOSTT dhe rrjetit evropian ENTSO-E. Marrëveshja do të sigurojë pavarësinë energjetike të Republikës së Kosovës dhe afrimin e saj me tregun e energjisë së Republikës së Shqipërisë.

- Është nënshkruar marrëveshja e grantit me Bashkimin Evropian përmes Bankës Botërore në vlerë prej 9.4 milionë euro që ka për qëllim mbështetjen financiare të Projektit për Efiçencë në Energji dhe Energji të Ripërtëritshme.

- Është hartuar strategjia për renovimin e ndërtesave të banimit në kuadër të Agjencisë së Efiçencës së Energjisë dhe ka kryer studimin e fizibilitetit për skemën obligative, gjithashtu po punohet në ngritjen e shoqatave banesore, të cilat do të zbatojnë masa të efiçencës së energjisë.

foto 14

Kryeministri Kurti në minierën e Trepçës për 31-vjetorin e grevës së minatorëve.



09

# Kultura dhe sporti



foto 15

Ministrja Dumoshi / Në Ditën Ndërkombëtare të Muzeve,  
në Kosovë rithemelohej Muzeu i Historisë së Natyrës

## Arti dhe kultura

Për realizimin e politikave të qëndrueshme në fushën e artit dhe kulturës janë ndërmarrë shumë veprime të cilat kanë ndikuar në ruajtjen dhe zhvillimin e këtyre fushave. Për më shumë, gjatë situatës së krijuar si pasojë e pandemisë Institucionet kulturore kanë vazhduar aktivitetet e tyre në platforma digjitale dhe virtuale. Në këtë mënyrë **Teatri Kombëtar i Kosovës** i ka transmetuar rreth 30 shfaqje përmes rrjeteve sociale të Teatrit, me moton “Teatri në shtëpi”; **Galeria Kombëtare e Kosovës** për publikun kosovar ka sjellë ekspozitat e saja në mënyrë virtuale, ka sjellë disa ekspozita në format 360 shkallë si dhe ka promovuar artistë të vjetër e të rinj përmes serisë “Artistë në karantinë”; **Qendra Kinematografike e Kosovës** ka transmetuar një numër të konsiderueshëm të filmave që janë produksion i QKK-së në televizionet nacionale vendore por edhe ne platformat tjera

digjitale si Gjirafa video; **Ansambl i Këngëve dhe Valleve Shota dhe Baleti Kombëtar i Kosovës** kanë transmetuar shfaqjet dhe koncertet e tyre në televizionet nacionale dhe në rrjetet e tyre sociale; **Filharmonia e Kosovës** ka sjellë tri koncerte, njërin nga të cilët e ka transmetuar për Ditën e Kushtetutës së Kosovës.

## Libri dhe veprimtaria botuese

Në kuadër të politikave për përkrahjen e veprimtarisë botuese, është mbyllur thirrja publike për përkrahjen e botimit të librit, blerjes së librit dhe botimit të revistave letrare dhe tanimë është në fazën përfundimtare përzgjedhja e përfituesve nga kjo thirrje publike.

Janë ndarë gjithashtu çmimet vjetore të letërsisë dhe çmimi kombëtar për vepër jetësore në fushën e letërsisë.



## Përmirësimi i infrastrukturës kulturore

Pasi që zgjerimi i rrjetit të kinemave publike paraqet prioritet qeveritar, gjatë kësaj periudhe është nënshkruar Marrëveshja e Mirëkuptimit (MoU) në mes të Qendrës Kinematografike të Kosovës dhe Tatino Films, Qendrës Kombëtare të Kinematografisë së Shqipërisë, Qendrës së Filmit të Malit të Zi dhe Agjencionit të Filmit të Maqedonisë Veriore.

Gjithashtu, është përgatitur Kalendari i përbashkët kulturor me Republikën e Shqipërisë.

Siç është e ditur botërisht, Prishtina do të jetë nikoqire të edicionit të 14 të Manifesta-s (Bienales së Evropës Nomadike) për vitin 2022. Lidhur me këtë ngjarje, është përpiluar dhe dërguar Marrëveshja e Mirëkuptimit (MoU) për nënshkrim, si dhe është diskutuar përfshirja e komunitetit artistik në proces.

## Në veçanti është diskutuar edhe prospekti i ndihmës në themelimin të Muzeut të Arteve Bashkëkohore dhe Moderne me ndihmë edhe nga institucione simotra në Francë, Holandë, SHBA, Gjermani.

Në lidhje me krijimin e infrastrukturës fizike të objekteve kulturore, gjatë kësaj periudhe kanë vazhduar punimet për implementimin e disa projekteve të investimeve kapitale për objektet e ndryshme kulturore, siç janë: Ndërtimi i Qendrës Kulturore në Rogovë të Hasit, Komuna e Gjakovës, Ndërtimi i Bibliotekës dhe Arkivit në Shtime, Ndërtimi i Qendrës Kulturore dhe Rinore në Komunën e Hanit të Elezit, Ndërtimi i Qendrës së Kulturës “Ukë Bytyci” në Komunën e Suharekës, Rinovimi i Shtëpisë së Kulturës “Hasan Prishtina” në Komunën e Vushtrrisë, Rinovimi i Bibliotekës Kombëtare të Kosovës “Pjetër Bogdani”, Rinovimi i Qendrës së Kulturës “Isa Kastrati” në Komunën e Kamenicës etj.

## Mbështetja financiare për kulturën

Në përputhje me objektivat dhe programet vjetore, tashmë është ndarë buxheti për institucionet vartëse të kulturës: Teatri Kombëtar i Kosovës, Filharmonia e Kosovës, Baleti Kombëtar i Kosovës, Galeria Kombëtare e Kosovës, Qendra Kinematografike e Kosovës, Kosovafilmi, Ansambli i Këngëve dhe Valleve Shota.

Sa i përket përkrahjes së kulturës së pavarur, është në fazën përfundimtare vlerësimi i aplikimeve për mbështetjen financiare të organizatave të pavarura kulturore dhe krijuesve e performuesve. Përmes këtij procesi, financohet pjesa më e madhe e aktiviteteve kulturore në gjithë territorin e Kosovës, në të gjithë sektorët e kulturës.

Për më shumë, janë mbyllur konkurset për përzgjedhjen e laureatëve të çmimeve për fushën e teatrit dhe të muzikës si dhe është publikuar konkursi për Çmimet në fushën e kinematografisë dhe konkursi për Çmimet në fushën e Artit Pamor.

Promovimi i kulturës së Kosovës do të bëhet edhe me pjesëmarrjen në Ekspozitën e 17 Ndërkombëtare të arkitekturës, në Bienalen e Venedikut 2020. Për pjesëmarrje në këtë ngjarje të rëndësishme kulturore ndërkombëtare janë kryer të gjitha përgatitjet e nevojshme, duke u emëruar kuratori, përzgjedhur ekipi, punuar projekti si dhe përgatitjet e tjera të nevojshme.

Kosova ka vazhduar gjatë këtyre muajve koordinimin me Bashkimin Evropian në lidhje me pjesëmarrjen e Kosovës në programin e Komisionit “Evropa Kreative”.

## Mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore

Për sigurimin e mbrojtjes dhe promovimit të nevojshëm së trashëgimisë kulturore, është shtuar në planin legjislativ për 2020, Projektligji për Plotësimin dhe Ndryshimin e Ligjit për Trashëgiminë Kulturore. Ky projektligj parashihet të hartohet gjatë këtij viti. Gjithashtu, me qëllim të efikasitetit më të madh, janë rishikuar dhe përcaktuar prioritetet në fushën e konservimit-restaurimit dhe zbatimit të projekteve konkrete, duke përfshirë këtu me theks të veçantë ndërtesat me status të mbrojtjes në qendrën historike të Prishtinës dhe të Prizrenit. Ka vazhduar edhe bashkëpunimi me Zyrën e BE-së për projektet të cilat do të implementohen në kuadër të fondit të IPA :

- a) Revitalizimi i rrugës Marin Barleti,
- b) Kino Lumbardhi ne Prizren,
- c) Qyteti i vjetër Janjevës dhe
- d) Parku arkeologjik –“ Ulpiana”

Kanë filluar përgatitjet për shënimin e Ditës Ndërkombëtare të Muzeve me datë 18 maj 2020.

### Sporti

Në këtë fazë janë përgatitur obligimet te cilat kanë qenë pjesë e aprovimeve paraprake sipas kontratave si në infrastrukturën sportive, po ashtu në subvencione tek organizatat sportive të vitit 2019. Aktualisht Departamenti i Sportit është në proces të realizimit të pagesave të cilat janë obligim.

Me miratimin e Ligjit nr. 07/l-001 mbi ndarjet buxhetore për buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, është përgatitur plani i punës me aprovimin e politikave programore duke proceduar me projektet të cilat kanë qenë pjesë e aktiviteteve të prokurimit. Për fund, janë ndarë 10 bursa për shpresat Olimpikë dhe para Olimpikë në pajtueshmëri me Rregulloren Nr.03/2013.

### Modernizimi i infrastrukturës sportive

Pas takimeve të shumta me sportistë/e si dhe përfaqësues të sportit në Kosovë janë nënshkruar disa memorandume bashkëpunimi. Ndër to është edhe memorandum i bashkëpunimit me Federatën e Xhudos të Kosovës, për bashkëfinancim në realizimin e projektit “**Ndërtimi i Qendrës Nacionale të Xhudos në Pejë**”, i cili do të realizohet gjatë këtij dhe vitit të ardhshëm, me një shumë të përgjithshme prej 460 mijë euro, nga të cilat MKRS-ja ndan mbi 300 mijë euro.

### Rinia

Është lansuar thirrja për aplikim për OJQ për trajnimin e të rinjve për ndërmarrësi dhe trajnime profesionale të cilat janë të nevojshme për tregun e punës. Në fillim të këtij viti janë mbështetur tri projekte që janë partneritete të qendrave rinore dhe këshillave të veprimit rinor në bashkëpunim me GIZ-in gjerman.

Në kontekst të COVID-19, Departamenti i Rinisë ka koordinuar bashkëpunimin e MKRS dhe UNKT lidhur me organizimin e dy koncerteve online për shkak të situatës me COVID-19 me këngëtarë vendorë me temë luftimin e gjuhës së urrejtjes së të rinjve në kuadër të aktiviteteve të përbashkëta gjatë kohës së izolimit nga pandemia.



10

# Mbrojtja dhe siguria

**Ministria e Mbrojtjes është angazhuar që në bashkëpunim me ministrinë e linjës dhe të gjitha institucionet vendore të përfshira në luftimin e pandemisë COVID-19 duke realizuar 592 aktivitete transportuese, janë vendosur 16 tenda dhe pajisje përcjellëse në qendra mjekësore në komuna, janë transportuar dhe vendosur 4 kontenjerë në pikat kufitare, si dhe janë mbështetur Shtabet Emergjente Komunale.**

### **Forcat e armatosura**

Qeveria e Republikës së Kosovës është angazhuar që edhe gjatë kësaj periudhe të trajtojë me prioritet sektorin e mbrojtjes dhe sigurinë.

Bazuar në objektivat shtetërore të vendosura edhe në Programin e Qeverisë, Ministria e Mbrojtjes në bashkëpunim me institucionet tjera ka vazhduar hartimin e strategjive dhe politikave kryesore me qëllim të përfundimit i dokumenteve strategjike dhe atyre **planifikuese**.

Në këtë drejtim, janë hartuar draftet e **Strategjisë së Mbrojtjes dhe Strategjisë së Burimeve Njerëzore**, grupet punuese të së cilave udhëhiqen nga kjo Ministri, ndërsa është formuar grupi punues për hartimin e **Strategjisë Shtetërore për Siguri Kibernetike**.

Gjithashtu, ka vazhduar hartimi i politikave sipas planit vjetor si në vijim: Politika e Zhvillimit të Integjencës, Politika për Planifikim, Programim, Buxhetim dhe Ekzekutim, Politika për Standardizim në FSK, e Modernizimit në FSK, Politika e Vlerësimit dhe Menaxhimit të Rrezikut për sistemet e TI-së, etj.

Me qëllim të realizimit të Politikës për Standardizim dhe asaj për Modernizim të FSK-së, është vazhduar plotësimi i ligjeve dhe akteve tjera. Kështu, **ka filluar hartimi i Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për deminim humanitar**. Tutje, Koncept dokumenti për dërgim të FSK-së jashtë vendit ka kaluar konsultimet paraprake. Janë themeluar ekipet punuese dhe ka vazhduar hartimi i Koncept dokumentit për Komponentin Rezervë si dhe Koncept dokumentit për Policinë Ushtarake. Sa i përket Koncept dokumentit për shërbimin e obligueshëm ushtarak, janë zhvilluar diskutime me partnerë dhe analizat e nevojshme për inicim të hartimit të tij.

Në aspektin e rregulloreve, janë miratuar Rregullorja për rezervat për qëndrueshmëri operationale të FSK-së si dhe Rregullorja për zhvillimin e karrierës së pjesëtarëve të FSK-së. Ndërsa në konsultime paraprake gjenden Projekt Rregulloret lidhur me rekrutim, shërbimin shëndetësor dhe mirëmbajtje.

### **Legjislacioni dhe dokumentet rregullative për Forcën e Sigurisë së Kosovës**

- Është publikuar Hierarkia e Dokumentacionit në FSK dhe Koncepti i Ushtrimeve 2021-2023. Gjithashtu, janë përcaktuar Procedurat Administrative të SHP FSK dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës. Po ashtu, është finalizuar Direktiva e Planifikimit 2021-2023 dhe janë duke u vendosur nën-programet dhe element programet e Mbrojtjes që lidhen me procesin analitik të blerjeve ushtarake.

Sa i përket Dokumenteve Doktrinare, janë finalizuar Doktrina e Integjencës dhe ajo e përgjithshme e Operacioneve në FSK, ndërsa janë në proces Doktrina e Personelit, e Logjistikës, dhe manualet e fushave të ndryshme.

**Pyetësi i Transparency International** - Për herë të parë Republika e Kosovës, gjegjësisht Ministria e Mbrojtjes ka udhëhequr rishikimin e Pyetësit të Transparency International për indeksin e korrupsionit në strukturat e mbrojtjes dhe sigurisë. Ministria me këtë rast ka dhënë komente shtesë dhe ka përcjellë përgjigjet e para në vitin 2019.

**Vazhdimi i implementimit të Planit Gjithëpërfshirës të Tranzicionit dhe planeve mbështetëse me qëllim arritjen e aftësive operationale** - Plani Gjithëpërfshirës i Tranzicionit pasqyron dhe përfshin ndryshimet kryesore që duhet të ndodhin vit pas viti në mbajtjen e kapaciteteve ekzistuese (MUAC), ngritjen e njësive të reja për mision mbrojtjen e integritetit dhe sovranitetit territorial dhe në përgjithësi procesin e transformimit të FSK-së. Ky Plan është temporalizuar me zhvillimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, me shqyrtimin e pastërtisë së figurës, procedurat e verifikimit, deklarimin e pasurisë, kontrollin e brendshëm në institucion.

**Projektet** – Kanë vazhduar 5 projekte infrastrukturore nga viti i kaluar, 7 projekte janë dizajnuar së bashku me hartimin e dokumentacionit tekniko investiv. Është bërë prioritizimi i projekteve kapitale për vitin 2020. Me qëllim të modernizimit të sistemeve të armatimit dhe pajisjeve ushtarake, kanë filluar proceset për blerjen e element programeve dhe sistemeve të armatimit përmes programit FMS (Foreign Military Sales). Gjithashtu, FSK është në proces të realizimit të projektit për furnizim me HMMWV dhe mjete tjera ushtarake. Vlen të përmenden donacionet veçanërisht nga SHBA-të, por edhe nga Holanda, Gjermania dhe Britania e Madhe.

foto 16 - 17  
22 vjetori i Epopesë së UÇK-së

## Policia

Pothuajse tërë periudha e 100 ditëve të para të funksionimit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike ka qenë në **luftimin e pandemisë COVID-19**.

Në muajin mars është nënshkruar vendimi për aktivizimin e Planit të Reagimit Kombëtar, me ç’rast është themeluar edhe Grupi Ndër - Institucional për Menaxhimin e Incidenteve (GNMI) i cili ka bashkërenduar dhe organizuar veprimet lidhur me parandalimin e përhapjes së pandemisë COVID-19.

Me aktivizimin e këtij grupi (GNMI-së) dhe Planit të Reagimit Kombëtar, Ministria ka ngritur edhe Qendrën Operative të Ministrisë, të cilën e përbëjnë zyrtarët e Ministrisë, të Policisë së Kosovës, Forcave të Sigurisë së Kosovës, Agjencisë Kosovare për Inteligjencë dhe Agjencisë për Menaxhimin e Emergjencave, përfshirë institucionet tjera relevante.



Qendra Operative ka koordinuar:

- Riatdhesimin e më shumë se 1,281 personave nga pikë kalimet kufitare dhe fluturimet e organizuara për në Qendrën e Studentëve e cila u shndërrua në karantinë me një kapacitet prej 520 persona dhe gjatë periudhës raportuese më shumë se 1,180 persona kanë kaluar në këtë karantinë.
- Si karantinë dhe qendra shtesë për akomodim të personave u rregulluan për përdorim edhe disa vende të tjera si: qendra e të huajve në Vranidoll me një kapacitet të akomodimit prej 97 personave, Akademia e Kosovës për Siguri Publike me një kapacitet të akomodimit prej 140 personave, por me mundësi akomodimi për 600 persona të tjerë, si dhe Kampi Belvedere në Mitrovicë me një kapacitet prej 150 persona, me mundësi për të arritur në kapacitetin e 400 personave.

Me datë 20 mars janë ndaluar shëtitjet në parqe anembanë territorit të Republikës së Kosovës si dhe është urdhëruar shtimi i prezencës policore në këto pjesë në mënyrë që vendimi të implementohet në përgjithësi. Mirëpo, në mënyrë që të mos kufizohet liria e lëvizjes për stafin mjekësor, u është lejuar të gjitha autoambulancave që të kalojnë kufijtë e Republikës së Kosovës për të mundësuar veprimin e shpejtë dhe për t'u përgjigjur nevojave të qytetarëve.

Poashtu u është mundësuar zyrtarëve të bankave, stafit esencial të misioneve diplomatike, stafit esencial të administratës shtetërore, përfshirë edhe nivelin komunal, OJQ-të, subjektet politike, etj, qarkullimi i lirë me leje me qëllim të implementimit të detyrave të tyre zyrtare. Në vazhden e kësaj janë dhënë leje qarkullimi për rreth 12,000 persona.

Në të gjitha komunat janë ngritur Shtabet Emergjente Komunale, si dhe janë funksionalizuar Qendra Operative dhe ka vazhduar koordinimi me këto shtabe si dhe informimi i tyre për trajtimin e kërkesave të qytetarëve.

Gjithashtu, në mënyrë që qytetarët të informohen lidhur me hapat e ndërmarra nga institucionet për menaxhimin e pandemisë, është iniciuar kampanja e vetëdijesimit, përmes videoincizimeve të ekzekutuara me ndihmën e Planit të Kombeve të Bashkuara për Zhvillim dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë.

Në kuadër të masave për parandalimin e përhapjes së virusit COVID-19 u.d. i Ministrit ka realizuar mbi 15 vizita pikave kufitare si dhe shtabet operative nëpër komuna.



11

# Politika e jashtme, integrimi dhe mërgata



## Politika e jashtme dhe diplomacia

Si hap fillestar për fuqizimin e diplomacisë kosovare, Është bërë kërkesa për kthimin e ambasadorëve politikë, të cilët kanë përfunduar mandatin katër vjeçar, të paraparë sipas ligjeve në fuqi. Zëvendësimi i tyre do të ndikojë në uljen e kuotës politike, që aktualisht është 75% ambasadorë politikë dhe vetëm 25% ambasadorë të karrierës.

Gjithashtu, për herë të parë nga themelimi i MPJ-së, është shpallur konkurs i brendshëm ku diplomatët mund të konkurrojnë për t'u dërguar në njërin nga misionet diplomatike të Republikës së Kosovës. Gara e brendshme dhe procedurat transparente do të garantojnë përzgjedhjen më të mirë të mundshme të diplomatëve, që do t'i zgjerojnë e thellojnë raportet me vendet e tjera dhe do t'i mbrojnë interesat e Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare.

Në mënyrë që kuadrot e reja profesionale të kontribuojnë në institucionet kosovare, është urdhëruar ekzekutimi i procedurave administrative dhe punësimi i një bursiste nga Skema Celula e të Rinjëve në MIE e cila ishte në pritje të qëllimshme. Poashtu, është dërguar shkresa drejtuar të gjitha Ministrive të Linjës për priorizimin e rekrutimit të bursistëve nga Skema Celula e të Rinjve në administratë publike, më 27.02.2020.

Pasi që thellimi i marrëdhënieve dypalëshe është prioritet qeveritar, nga data 5 mars Ministri i MPJD-së ka zhvilluar takime kurtuazie me një numër të madh të ambasadorëve rezidentë dhe jo rezidentë në Republikën e Kosovës, ku janë trajtuar marrëdhëniet dypalëshe dhe mundësitë e thellimit të marrëdhënieve.

Së bashku me Kryeministrin, nga data 14 - 16 shkurt 2020, Ministri i MPJD-së ka marrë pjesë në Konferencën e Sigurisë në Muni. Gjatë konferencës janë zhvilluar takime të shumta si e Sekretarin e Shtetit të MPJ-së së Gjermanisë, Andreas Michaelis; me Ministrin e Jashtëm të Sllovakisë, Miroslav Lajčak; me Kryeministrin Marjan Šarec, së bashku me Ministrin e Jashtëm, z. Miroslav Cerar; me Kryeministrin e Bullgarisë, Boyko Borisov; me Ndhimës sekretarin e Shteteve të SHBA-ve, Philip T. Reeker; me Ministren e Mbrojtjes së Maqedonisë së Veriut, z. Shekerinska; me Sekretarin e Përgjithshëm të SPD-së, Lars Klingbeil; me Drejtorin Politik të BOM-së, z. Richard

Moore; me Sekretarin e Përgjithshëm të Interpolit, z. Jürgen Stock; me Kryeministrin e Kroacisë, z. Andrej Plenkovic, së bashku me Ministrin e Jashtëm, z. Gordan Grli Radman; me udhëheqësin e Grupit Parlamentar të CDU-së, z. Ralph Brinkhaus; me zëdhënësin e Fraksionit CDU/CSU Jürgen Hardt; me deputetët e CDU-së, Peter Beyer dhe Christian Schmidt etj.

## Integrimi euro-atlantik

**Takimi i Selanikut** - Më 24 shkurt 2020, Ministri ka marrë pjesë në Konferencën e Nivelit të Lartë për Perspektivën Evropiane të Ballkanit Perëndimor "Nga Selaniku në Zagreb", që u mbajt në Selanik, me pjesëmarrjen e shefave të diplomacive të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe në prani të Presidencës Kroate, të Bashkimit Evropian, të Shërbimit të Jashtëm të BE-së, si dhe të përfaqësuesve të Komisionit Evropian.

**Takimi i Pragës** - Më 26 dhe më 27 shkurt, Ministri i Punëve të Jashtme dhe i Diasporës i Republikës së Kosovës, z. Glauk Konjufca në Pragë, mori pjesë në Takimin Vjetor të Ministrave të Punëve të Jashtme të Grupit të Vishegradit (Çekia, Sllovakia, Hungaria dhe Polonia) dhe të vendeve të Ballkanit Perëndimor, nën kryesimin e radhës të Republikës së Çekisë.

Është përpiluar dhe dërguar Inputi për Raportin për Vendin 2019 për Komisionin Evropian, i cili ka përmbledhur kontributin nga të gjitha institucionet qeveritare.

Janë përmirësuar raportet dhe është kthyer besimi në proces nga akterë Evropianë të cilët kanë mirëpritur reformat e filluara nga qeveria dhe kanë shprehur mbështetje të pa rezervë për qeverinë duke përfshirë edhe pakon financiare të ndihmave për COVID-19 dhe pakos për ndihma financiare që synon të jetë mbi 150 milionë euro.

Gjatë 100 ditëshit, Ministria për Integrim Evropian ka arritur të përmirësojë raportet dhe ri-kthejë besimin në procesin Euro-integrues tek akterët Evropianë, të cilët kanë mirëpritur reformat e filluara nga qeveria dhe kanë shprehur mbështetje të pa rezervë për qeverinë duke përfshirë edhe pakon financiare të ndihmave për COVID-19 dhe pakos për ndihma financiare që synon të jetë mbi 150 milionë euro.

Përkundër anulimit të vizitave të konfirmuara zyrtare në: Bruksel, Lisbonë e Vienë, shkak i pandemisë COVID-19, gjatë këtyre tre muajve Ministri i Integritimit Evropian ka realizuar rreth 30 takime direkte apo “në distancë” me zyrtarë të lartë të BE-së, si me: Nën-Kryetarin e Parlamentit Evropian Rainer Wielden, Zyrtarin e Lartë të Komisionit Evropian David Culen, me Ministren Federale për BE dhe Kushtetutë të Austrisë Karoline Edtstadler, me Kryetarin e Komitetit për Ballkanin Përendimor në Parlamentin Evropian Tonino Picula, me Ministrin për Evropë dhe Punë të Jashtme të Shqipërisë Gent Cakaj, pastaj takime të rregullta me Kryesuesen e BE-së, ambasadorën e Kroacisë Danijela Barisliq dhe Ambasadorën e BE Natali Apostolova, si dhe me 12 ambasadorë të shteteve anëtare të BE-së të akredituar në Prishtinë.

Gjatë kësaj periudha Ministria për Integritim Evropian ka përpiluar dhe dërguar Inputin për Raportin për Vendin 2019 për Komisionin Evropian, i cili ka përmbledhur kontributin nga të gjitha institucionet qeveritare.

Poashtu janë miratuar nismat për: “Marrëveshjen financiare për IPA 2019, pjesa e dytë”; për “Marrëveshjen financiare për IPA 2020 me Bashkimin Evropian”; për “Marrëveshjen financiare trepalëshe mes BE, Kosovës dhe Maqedonisë së Veriut për vitin 2019, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II”; për “Marrëveshjen financiare trepalëshe mes BE, Kosovës dhe Malit të Zi për vitin 2019, për Programin Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II; për “Marrëveshjen financiare trepalëshe mes BE, Kosovës dhe Shqipërisë për vitin 2019, për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA II; si dhe Udhëzimi Administrativ të Agjencisë për Krahasim dhe Verifikim të Pronës për përcaktimin e procedurave shkatërrimin e strukturave të paligjshme, si parakusht i plotësimit të kriterit politik në procesin e integritimit Evropian.

Është mbajtur takimi i Nën-Komitetit për mjedis, energji, transport dhe zhvillim rajonal, më 19 mars 2020 përmes video-konferencës në mes institucioneve të Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Është nënshkruar “Marrëveshja e Bashkëpunimit me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrinë së Integritimit Evropian të

Republikës së Kosovës për Mbështetjen e Ndërsjellë në Kuadër të Përgatitjes për Hapjen dhe Zhvillimin e Negociatave të Pranimit”, më datë 24 prill 2020.

### **Fqinjësia e mirë dhe bashkëpunimi rajonal**

Është mbajtur takimi i Nën-Komitetit për mjedis, energji, transport dhe zhvillim rajonal, më 19 mars 2020 përmes video-konferencës në mes institucioneve të Kosovës dhe Komisionit Evropian.

## **Është nënshkruar “Marrëveshja e Bashkëpunimit me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme të Republikës Së Shqipërisë dhe Ministrinë së Integritimit Evropian të Republikës së Kosovës për Mbështetjen e Ndërsjellë në Kuadër të Përgatitjes për Hapjen dhe Zhvillimin e Negociatave të Pranimit”, më datë 24 prill 2020.**

Gjatë periudhës raportuese është emëruar udhëheqësi i Zyrës së Këshillit për Bashkëpunim Rajonal, i cili njëherësh është këshilltar politik e i cili është ngarkuar me çështje të koordinimit me SHERRPA dhe zbatimin e Planit Shumëvjeçar të Veprimit për Zonën Ekonomike Rajonale për të cilën u ra dakord në Samitin e Trieshtes, korrik 2017.

Në **zbatimin e Ligjit për Persona të Zhdukur**, gjatë kësaj periudhe kohore familjeve iu janë kthyer për rivarrim mbetjet mortore të dy personave të zhdukur, të identifikuar. Në kuadër të bashkëpunimit rajonal është mbajtur një takim i Grupit Punues për Persona të Zhdukur në përbërje të plotë (mes

*Delegacionit të Kosovës dhe Delegacionit të Serbisë, me ndërmjetësimin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq), si dhe një takim paraprak mes udhëheqësve të delegacioneve dhe sekretariateve të delegacioneve. Gjatë takimit të Grupit Punues është iniciuar ‘rasti i Sjenicës’ dhe janë ri-prezantuar kërkesat për disa raste të tjera, si dhe janë aprovuar ‘Rregullat e përditësuara të punës të Nëngrupit Punues për Mjekësi Ligjore’. Krahas takimit, është realizuar edhe vizita në lokacionin e shënjuar në Kizhevak, Rashkë (Serbi) në të cilin, sipas informatave të prezantuara nga Delegacioni i Serbisë pritet të punohet edhe gjatë këtij viti.*

Po ashtu në kuadër të bashkëpunimit rajonal, është mbajtur një takim mes Komisionit Qeveritar për Persona të Zhdukur i Republikës së Kosovës, Komisionit të Malit të Zi për Persona të Zhdukur dhe, Komisionit të Serbisë për Persona të Zhdukur, me ndërmjetësimin e Komisionit Ndërkombëtar për Persona të Zhdukur, në përpjekje për gjetjen e zgjidhjes për ‘publikimin e Bazës së të Dhënave Rajonale’, me qëllim edhe të zbatimit të Planit Kornizë Rajonal për Persona të Zhdukur.

Gjatë kësaj periudhe kohore është punuar edhe në çështjen e marrëveshjeve dypalëshe të bashkëpunimit në procesin e ndriçimit të fatit të personave të zhdukur me Republikën e Kroacisë dhe me Bosnjë e Hercegovinën, duke adresuar edhe diskutimet nga takimet e përbashkëta rajonale dhe bilaterale të mbajtura në fund të muajit janar, përkatësisht në fillim të muajit shkurt, në Prishtinë.

Në fillim të muajit mars, me përkrahjen e UNDP-së në implementim të projektit të financuar nga Ambasada Britanike, është organizuar ‘Punëtorja me zyrtarët komunal për çështjen e personave të zhdukur’.

Po ashtu me përkrahje të UNDP-së dhe financim të Ambasadës Britanike, gjatë këtyre ditëve kemi **zhvilluar ‘aplikacionin gjurmues i lokacioneve përmes ueb faqes’**, i cili së shpejti do të publikohet, si një mundësi për rritje të transparencës dhe sigurimit të informatave të reja.

Në bashkëpunim me shoqatat e familjeve të personave të zhdukur, në bazë edhe të praktikave nga vitet paraprake, jemi angazhuar në realizimin e aktiviteteve, brenda rrethanave të krijuara si pasojë e pandemisë, për shënimin e përvjetorëve të ‘masakrave dhe datave të zhdukjeve të dhunshme, përfshirë

edhe **27 prillin – Dita e të Pagjeturve të Kosovës**, ku krahas përkujtimit dhe nderimit të të gjithë personave të zhdukur dhe dhimbjes së familjarëve, përmes këtyre aktiviteteve është bërë përpjekje edhe për një informim të drejtë dhe sensibilizim të opinionit vendor dhe ndërkombëtar për gjendjen aktuale të procesit të ndriçimit të fatit të personave të zhdukur.

Në kuadër të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal kanë vazhduar tri programe ndër-kufitare si në vijim:

— Programi i BNK – Maqedoni Veriore, IPA II, 2014-2020. Ka vazhduar implementimi i 4 projekteve përfitues nga thirrja e parë dhe e dytë për projekt propozime, në zonën e Programit në të dy anët e kufirit.

— Programi i BNK Shqipëri – Kosovë, IPA II, 2014-2020. ka vazhduar implementimi i 5 projekteve përfituese nga thirrja e parë për projekt propozime, në zonën e Programit në të dy anët e kufirit. Vlera e përgjithshme e projekteve përfituese është 2,212,661 euro. Lidhur me këtë, janë kontraktuar 2 projekte strategjike.

— Programi i BNK Kosovë – Mali i Zi, IPA II, 2014-2020. ka vazhduar implementimi i 7 projekteve përfituese nga thirrja e parë për projekt propozime, në zonën e Programit në të dy anët e kufirit. Vlera e përgjithshme e projekteve përfituese është 1,976,011 euro + 15% bashkëfinancim. Ndërsa, në proces të kontraktimit janë 6 projekte.

Pas ndryshimit të misionit të MM-së dhe FSK-së, ka qenë e nevojshme rishikimi i Marrëveshjeve Bilaterale (MOU) me shtetet partnere në kuadër me statusin e ri. Janë nënshkruar apo kanë hyrë në fuqi planet bilaterale me: SHBA, Turqi, Gjermani, Holandë, Shqipëri dhe Francë. Janë koordinuar aktivitete me ODC, Gardën Kombëtare të IOWA, EUCOM dhe USAREUR, e draft-plane me Kroacinë dhe Maqedoninë e Veriut. Është bërë koordinimi i 7 aktiviteteve në kuadër të programit të IOWA. FSK po përgatit pjesëmarrjen e saj në operacionet e mbështetjes së paqes bashkë me Gardën Kombëtare të IOWA-SHBA në vitin 2021, në ushtrimin “KFOR 27”, apo dhe ushtrime të tjera në Hungari e Turqi.



foto 18  
Ministri Konjufca duke nënshkruar Vendim për Shfuqizimin e Vendimeve të Kundërligjshme

## Mërgata

**Riatdhesimi i qytetarëve të Republikës së Kosovës -** Pas pezullimit të linjave ajrore dhe rrugore nga Qeveria, si pasojë e pandemisë COVID-19, ka filluar angazhimi për riatdhesimin e qytetarëve të ngjuar në vende të ndryshme dhe në pamundësi të kthimit me forca individuale. Është bërë thirrja publike për identifikim të këtyre qytetarëve, ku fillimisht janë paraqitur më pak se 2,000 qytetarë. Si pasojë e mbylljes së kufijve nga shtetet tjera, është krijuar panik dhe si rrjedhojë numri i kërkesave ka shënuar rritje. Aktualisht, janë të paraqitur 2,841. Nga ta, 1,482 qytetarë janë riatdhesuar përmes linjave ajrore dhe rrugore. Poashtu është bërë riatdhesimi i 14 konsujve. Gjithsej janë realizuar 9 fluturime nga Institucionet e Kosovës, 1 fluturim nga EULEX-i, janë shfrytëzuar tri herë shërbimet e AirAlbania, 4 autobusë dhe disa konvoje veturash private.

Kërkesat aktuale të trajtuara dhe në proces për tu trajtuar			
Nr. Total	Emergjente	Joemergjente	Të kthyer
3043	1457	1550	1708



Meqë kapacitetet në Qendrën e Karantinë nuk kanë mundësuar kthimin e të gjithë qytetarëve në të njëjtën kohë, sepse është kërkuar respektimi i rekomandimeve të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, sa i përket higjienës dhe parandalimit të infektimit me virusin COVID-19, MJPD, në bashkëpunim me ambasadat e Kosovës ka krijuar lista të qytetarëve të ndara në 2 grupe: Rastet emergjente dhe rastet jo emergjente.

Për ta përsheptuar procesin e kthimit, pas rekomandimeve të publikuara nga IKShPK, MPJD në bashkëpunim me ambasadat në Gjermani dhe Zvicër ka krijuar lista për raste, që parimisht i plotësojnë kushtet për vetizolim, por duke përfshirë edhe persona që nuk i plotësojnë kushtet. Kjo metodologji do të vazhdojë edhe tutje për të avancuar me procesin e kthimit.

Pas pranimit të listave të ndara në kategori emergjente dhe joemergjente, ambasadat e Kosovës kanë parashtruar kërkesë përmes qendrave të themeluara për menaxhimin e krizave për riatdhesimin e personave të kategorisë së parë. Aprovimi për hyrje në RKS bëhet nga QOMPBP-ja dhe QOE-ja, në konsultim me MPJD-në, pas verifikimit se Qendra e Karantinës ka kapacitete për pranimin e qytetarëve, ndërsa leja e veçantë për realizimin e fluturimit aprovohet nga MIA.

Për kategorinë e personave, që nuk kanë arritur të përfshihen në listat fillestare për fluturimet e caktuara, MPJD-ja ka udhëzuar ambasadat, që në vendet ku ato janë të angazhuara, t'u dalin në ndihmë qytetarëve duke identifikuar familje të diasporës sonë, që janë të gatshme për t'i akomoduar ata, duke identifikuar biznese të mërgimtarëve shqiptarë, që janë të gatshme t'u ndihmojnë financiarisht ose me ushqim, dhe organizata humanitare për ndihmë të natyrave të ndryshme.



**Qeveria e Kosovës gjatë 100 ditëve ka reaguuar me kohë në luftimin e pandemisë COVID-19, ka ngritur besimin e qytetarëve të Kosovës përmes shkarkimeve të personave jo kompetent dhe keqpërdorues, ka minimizuar shpenzimet me paranë publike dhe ka rritur transparencën e institucioneve publike.**





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada-Government*

*Zyra e Kryeministrit - Ured Premijera - Office of the Prime Minister*